



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN

01 Nr. / Br 29/25

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 14.02.2025

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 shkurt 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D I T E**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 janar 2025.
2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.
3. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha (post-mortum).
4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”.
5. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
6. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024.
7. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.
8. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.
9. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.
10. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.
11. Kërkesë për përkrahje financiare.
12. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRAN

Of. Nr. / Br. 28/25

Nr. i fq. / Br. st. -2-

Data / Datum 14.02.2025

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

<b>PËR:</b>	<b>Kuvendin e komunës</b>
<b>NGA:</b>	<b>Melihate Basholli Latifi</b> <b>Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>
<b>PËRMES:</b>	<b>Sekretarisë së Kuvendit</b>
<b>TEMA:</b>	<b>Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 14.02.2025</b>

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **14 shkurt 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
2. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
3. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
4. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
5. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
6. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.  
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***  
***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

7. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
9. Kërkesë për përkrahje financiare.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
10. Propozim - vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit”.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
11. Propozim – vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por të themelohet një komision, i cili do t'i analizojë në mënyrë të hollësishme propozimet për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë.*

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E I E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,**  
**PËR VITIN 2025 MBAJTUR MË 30 JANAR, 2025**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasoje Stefanoviç, Refik Maloku, Ramadan Parduzi, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Sylejman Mehulli dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Nurie Halili, Zojë Hajrizi dhe Shkelzen Xhaferi.

Në fillim të mbledhjes, z. Ramadan Parduzi, dha betimin para kuvendi duke u bërë anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejta të plota.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 29 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –fillimisht i uroj të gjithë kandidatë të cilët po konkurrojnë për deputet në Kuvendin e Kosovës, uroj që të kenë sukses në misionin e tyre për tu bërë deputet. Më tej duk ju referuar normativit të Komisionit Qendror Zgjedhor, ku flitet për përshtatshmërinë e një kandidati për deputet, vlerësoi se këta kandidat duhet të jenë të suksesshëm që të mos e bëjnë shkelje ligjore gjatë kësaj gare. Ky normativ në formë urdhërore përcakton se kandidati duhet ta liroi vendin e punës gjatë fushatës elektorale. Një gjë të tillë e kishte përfillur edhe ai kur kishte qenë kandidat për asamblenë komunale në vitin 2021, të cilën vendim e kishte përfillur dhe ku decidivisht ishte e përcaktuar edhe perimetri deri në sa ka të drejt të iu afrohet institucionit ku punon kandidati.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** – kërkoi nga kandidatët që janë në garë që nëse kanë ndonjë konflikt me ligjin ta lirojnë sallën.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, përcjelli disa kërkesa të parashtruar nga ana e qytetarëve si: në fshatin Stanoc i Epërm në lagjen Buliqaj, Rakaj dhe Dobra, kemi një kërkesë për rregullimin e një kanalizimi që është i bllokuar i mbyllur, ku kërkoj nga Drejtoria përgjegjëse që kjo çështje të rregullohet sa ma parë, sepse aty po rrezikohet jeta e fëmijëve që e frekuentojnë atë rrugë ku është mbyllur kanalizimi. Mandej kërkesa tjetër ka të bëjë me një rrugë që është bërë e pakalueshme në Stanoc të Epërm lagjia Kosumi tek familja e Gazmend Kosumit, ku ata kanë kërkuar që komuna urgjentisht të intervenoj së paku me zhavorr, ashtu që fëmijëve të iu mundësohet qasje në rrugë dhe frekuentim në shkollë. Mandej ndriçimi publik në shumicën e fshatrave të komunës është i prishur dhe i pa mirëmbajtur dhe vërejtje ka pasur nga banorët e fshatrave: Mihaliq, Druar, Dumnicë, Gracë, Stanoc e Epërm dhe shumë fshatra të tjera, dhe kjo për faktin se kualitetit i këtij ndriçimi është jashtëzakonisht i dobët. Po ashtu në shumicën e rrugëve në fshatin Stanoc i Epërm si: rr.”Dalip Maloku” rr.”Myrvete Haradinaj”, rr.”Jeta” rr.”Skender Bllaca” dhe rrugë të tjera mungon ndriçimi publik ose ai është jo funksional dhe i pa meremetuar nga ana e kompanisë përgjegjëse. Në fund ngriti shqetësimin e punëtorëve të Ndërmarrjes Lokale “Përparimi” të cilëve për gjashtë muaj radhazi nuk është duke iu paguar trusti pensional. Kërkoj që kjo çështje të rregullohet sa më parë në të kundërtën do të iu drejtohen instancave tjera për këtë çështje.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –përsëriti duke lexuar disa rregulla të KQZ-së, ku njoftoj se zyrtaret publik që kanë kandiduar për një ulëse në Kuvendin e Kosovës, nuk kanë të drejt të marrin pjesë në seancat e kuvendit sepse favorizohen dhe ndikojnë në vendimmarrje të kuvendit dhe kjo vendimmarrje mund të kontestohet më vonë.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** – në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit sqaroi se si përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, detyrat e tij i ushtron konform ligjit, prandaj njoftoj se të gjitha detyrat tjera i ka pezulluar sipas dispozitave ligjore, dhe në konsultim edhe me shefin e personelit të Komunës së Vushtrrisë, njoftoi se pjesëmarrja e tij në seancën e kuvendit nuk paraqet kurrfarë konflikti me ligjin. Tutje në deklarimet jashtë rendit të ditës deklaroi ngriti disa çështje e ndër të tjera i bëri thirrje publike kryetarit të komunës së Vushtrrisë që ta ndalë presoni ndaj shërbyesve civil në Komunë e Vushtrrisë që po ushtrohet në këto ditë fushate paraelektorale në formë publike dhe private, që po vinë nga pushtet dhe qeveria lokale. Në këtë kontekst ai i bëri thirrje të gjithë zyrtarëve publik të Administratës së Komunës së Vushtrrisë, të mos bien pre e presonit nga pushteti lokal, dhe të denoncojnë çdo rast që bie ndesh me ligjet në fuqi di preson dhe detyrim, ndërsa ai u zotua se si opozitë do të jenë pranë tyre në çdo rast. Pastaj çështja tjetër që e ngriti është fakti se bizneset në sheshin e Vushtrrisë kanë falimentuar, si rezultat i zhegjitjeve dhe menaxhimit jo të duhur të projektit ndërtimi i parkingut nëntokësorë në shesh. Në këtë kontekst i bëri thirrje kryetarit të komunës që të dal dhe të iu kërkoj falej të gjitha atyre bizneseve që i ka sjellë në këtë gjendje. Ai potencoj dhe kërkoj nga ato biznese që të ushtrojë kallëzime penale ndaj komunës, për humbjet që i kanë pasur si rezultat i shkatërrimit të infrastrukturës për rreth bizneseve të tyre. Mandej kërkoj nga Drejtoria përgjegjëse që për objektin që gjendet afër taksistëve që dukur ka shërbyer si fabrikë e vajit, në të cilën tani kanë filluar disa punime, të sillet leja e ndërtimit dhe kushte e ndërtimit, në qoftë se posedon leje dhe mbi çfarë baze është lëshuar ajo leje nëse është lëshuar. Në atë lokalitet është një fyt shumë i ngushtë dhe po i pengon qytetarët gjatë lëvizjeve të tyre.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar projektit ndërtimi i parkingut nëntokësor në shesh, pyeti kryeartin e komunës se ku mbeti premtimi i tij dhe zbatimi i vendimit për subvencionimin e bizneseve që shtrihen për gjatë këtij sheshi. Ai ftoj qeverisjen komunale që të

përgjigjet se përse nuk ka ndodhur një subvencionim i tillë. Në fund ai përkujtoj Sylejman Mehollit, se ai i ka tre apo katër deputet dhe lider i opozitës është veç nëse është vetëshpallur.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar parafolësve të tij, ceku se nuk është mirë që dikush të vjen në kuvend e të flasë, për preson ndaj zyrtarëve publik në komunë duke dezinformuar dhe duke mos paraqitur asnjë fakt. Lidhur me bizneset në sheshin “Adem Jashari”, vlerësoi se nuk ka informata se ndonjë biznes ka falimentuar ndërsa, ceku se ka hapje të bizneseve të reja, dhe atë institucione makro dhe mikro financiare. Në këtë kontekst ai vlerësoi se pretendimet e anëtarëve të kuvendit nga radhët e opozitës janë shpifje dhe të pavërteta.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar diskutimit të përfaqësuesit të LDK-së në kuvend z.Lahu, se kryetari i LVV-së në Vushtrri është vetëshpallur lider i opozitës shtoj se falë këtij të fundit, janë shpëtuar 20 hektarë tokë të komunës që do ti ndanin mes veti grupet e PDK-së dhe LDK-së.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-propozoi të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me përfaqësuesin nga radhët e LDK-së.

Në vazhdim kuvendi me vota “unanime” vendosi që ta inkorporoj në rendin e ditës për shqyrtim Peticionin e banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Syla, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.

Pas votimi kuvendi me 23 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi që ta inkorporoj në rendin e ditës për shqyrtim Propozim - vendimin për dhënien në menaxhim të Qendrës për Grumbullim Riciklim dhe Paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh.

Pas votimi kuvendi me 20 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi që ta inkorporoj në rendin e ditës për shqyrtim Propozim –vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 dhjetor 2024.
2. Peticioni i banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Syla, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.
3. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.
4. Kërkesë për mbështetje financiare për shërim për z.Adem Hasani.
5. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.
6. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.216/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh.

7. Rishqyrtimi dhe harmonizimi i vendimit me numër të protokollit 01.196/24 i datës 31.10.2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, për KEDS-in.
8. Propozim - vendim për dhënien në menaxhim të Qendrës për Grumbullim Riciklim dhe Paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh.
9. Propozim - vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
10. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 dhjetor 2024.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 24 vota “për” 1 votë “kundër” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 dhjetor 2024.**

2. Peticioni i banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Syla, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.

**Ali Mustafa, përfaqësues i lagjes Mustafa në fshatin Reznik**-në emër të lagjes Mustafa-Kosumi fshati Reznik, përshëndeti dhe falënderoj kryetarin e komunës dhe anëtarët e kuvendit për punën që po bëjnë. Më tej informoj se para disa ditësh kanë dorëzuar një peticion drejtuar kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në gjatësi afër 300 metra në fshatin Reznik. Prej vitesh kanë parashtruar në vazhdimësi kërkesa për rregullimin e kësaj rruge, por fatkeqësisht asnjëherë nuk kanë hasur në mirëkuptim, nga qeveritë e kaluar komunale. Kjo rrugë banorëve iu shërben për komunikacion, bujqësi, blegtori, duke zvogëluar kohën dhe distancën me rrugët tjera afërsisht prej 1.5 km. Rregullimi i kësaj rruge nuk është i nevojshme vetëm për dy lagjet Mustafa-Kosum, por edhe për lagjet Bunjaku, Syla një pjesë të lagjes Halili dhe lagjen Zeka. Duke u bazuar në kërkesën e lagjeve Mustafa-Kosumi, rregullimi i kësaj rruge do të mundësonte qarkullimin e mjeteve motorike për bujqësi si auto-kombajnat, për këta banorë që merren me bujqësi dhe pjesërisht me blegtori. Përdorimi i rrugës tjerë alternative për punimin e tokave të rrugës Vushtri-Mihaliq si ata e quajnë e bënë shumë të vështirë qarkullimin e këtyre banorëve. Duke marrë për bazë përkushtimin e qeverisë komunale, shpresojnë se kërkesa e tyre e drejt dhe e ligjshme do të realizohet në një afat të shpejtë për çka paraprakisht iu falënderojmë si lagje.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –njoftoi se personalisht sa ata kanë qenë në pushtet në mandatin e kaluar janë përpjekur që të zgjidhet kjo çështje duke e shtruar këtë rrugë. Por megjithatë aty ka pasur disa probleme mes fshatit lidhur me hapjen e asaj rruge, dhe kjo e ka penguar që ajo rrugë të hapet dhe të rregullohet për qarkullim. Në këtë kontekst ai vlerësoi se ndihet i lumtur që kjo kërkesë por shqyrtohet dhe aprovohet nga ana e kuvendit. Si grup kuvendar i LDK-së e përkrahin këtë kërkesë që ajo rrugë të shtrohet dhe njëta të jetë e hapur dhe funksionale.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –njoftoi se e mbështesin në plotëni kërkesën e këtyre banorëve për hapjen dhe rregullimin e asaj rruge. Ai shtoi se kjo është më e pakta që mund të bëjë qeverisja komunale, sepse në fshatin Reznik duhet të kemi edhe investime tjera në infrastrukturë si rrugë, kanalizim dhe trotuare të cilat nuk kanë ndodhur këto investime, në ndërkohë që kemi ndërtim të rrugëve nëpër male ku nuk ka asnjë banorë me fjalë tjera kemi investime kot. Tutje

shtoi se kërkesa e këtyre banorëve është plotësisht e ligjshme dhe e arsyeshme, andaj shpreson që qeveria komunale ta shtroj këtë rrugë në mënyrë sa më efektive dhe e njëjta të jetë e hapur dhe funksionale për qarkullimin e këtyre banorëve.

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit** –tha se grupi kuvendar i PDK-së e mbështet këtë kërkesë dhe kërkon që kjo çështje të shtyhet përpara ashtu që të kjo rrugë të hapet dhe të ndërtohet dhe të bëhet e kalueshme për qarkullim.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** –tha se e mbështetin këtë kërkesë dhe shtoj se kjo çështje për këtë rrugë ka pritur mjaft shumë për tu zgjidhur, andaj është i lumtur që kjo kërkesë po aprovohet dhe po zgjidhet kjo çështje, për faktin se këta banor kanë vuajtur mjaft shumë me halle dhe probleme. Ai kërkoj zotim nga kryetari i komunës që këtë çështje ta marr për sipër për ta quar deri në fund për ta ndërtuar dhe për ta hapur këtë rrugë për qarkullim.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –tha se e mbështetin këtë kërkesë, dhe kërkoj të sqarohet ashtu që mos të kemi probleme në implementimin e kësaj kërkesë në rrafshin që në kërkesë thuhet se gjatësia është 300 metra dhe kërkohet që gjerësia të jetë 8 deri në 10 metra gjë që është e pamundur sepse kjo gjerësi e rrugës është vetëm tek autostradat.

**Ergyn Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi**-në emër të qeverisë komunale deklaroi: se në konsultim me kryetarin e komunës dhe me Drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm, kanë nxjerr listën e të gjitha rrugëve të cilat konsiderohen si rrugë ta arave për punimin e arave, dhe është plan i komunës që këto rrugë të shtohen të paktën me zhavorr që të bëhen të kalueshme dhe që të iu mundësohet bujqve punimi i tokave të tyre. Në fund tha se nuk është mirë që në kohë fushate të përdoren bujqit për fushatë parazitgjedhore.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –tha se etika nuk e lejon që të përdorë foltoren për propagandë, për hire edhe të garës në të cilën ndodhet. Por e vërteta është se Drejtorja e Bujqësisë kurrë nuk ka pasur performancë më të dobët, si në shpenzim të buxhetit ashtu edhe në furnizimin e me mjete të punës për bujqit dhe këtë e dinë të gjithë fermerët e Komunës së Vushtrrisë.

**Ergyn Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi**-tha se zhvillimi i politikave në sektorin e bujqësisë, shkojnë kryesisht në rrafshin që të ndihmohen ata njerëz të cilët punojnë. Politikat e tyre kanë qenë të orientuar në subvencionimin e fermerëve, për lopë, bollica, subvencione për bletarët, subvencione me 5 cent për litër qumështi, subvencione për ujitjen e tokës në masën komosative etj. Kjo është politika e tyre, sepse në të kaluarën ka pasur blerje të mjeteve të punës po janë keqpërdorur nga pushteti i kaluar ato mjete.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** –tha se katër vite e kanë pasur pushtetin, këta që po flasin, dhe nuk kanë qenë në gjendje që këtë rrugë ta shtrojnë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-kërkoj të dihet afati se kur do të përfundoj rregullim dhe shtimi e hapja e kësaj rruge.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se vota e asamblistëve të AAK-së do të jetë pro për shtrimin dhe rregullimin e rrugës në fshatin Reznik. Tutje shtoj se këto partitë tjera të cilat të gjitha kanë qenë pushtet janë duke bërë filma sepse e kanë pasur mundësin që më herët të bëjnë rregullimin e kësaj rruge.

**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së**- tha se pas marrjes së vendimit nga kuvendit Drejtorja e Kadastrit do të dal në teren për ta piketuar këtë rrugë dhe për shtruar.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** –konstatoj se në këtë çështje kuvendit nxjerr vendim për aprovimin e peticionit, dhe obligon Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që bëjnë shënimin e pikave kah është rruga publike, ndërsa Drejtorja e Urbanizimit dhe Drejtorja e Shërbimeve Publike ta mirëmbajtën këtë vit me zhavorr, kurse në vitin 2026 të parashihet asfaltimi i kësaj rruge.



**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 26 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet peticioni i banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Sylja, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.
  2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë obligon Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë t'i caktojë pikat kah është rruga publike, ndërsa obligohet Drejtoria për Shërbime Publike si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta mirëmbajnë këtë vit me zhavor, këtë rrugë, kurse vitin e ardhshëm të parashihet asfaltimi i kësaj rruge.
  3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike që ta informoi Kuvendin e Komunës dhe parashtruesit e peticionit për veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë çështje.
  4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
  5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
3. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se ky raport vjetor i të hyrave dhe shpenzimeve tregon në mënyrën më të mirë rënie e performances së komunës, ku pas disa viteve të tejkalimit të inkasimit të hyrave, këtë vit komuna nuk ka arrit të inkasoj as të hyrat që vet i ka planifikuar. Komuna e Vushtrrisë është në një kaos financiar, nuk do të ketë mjete të mjaftueshme për ti mbuluar obligimet që kane mbetur nga viti i kaluar për shkak të marrjes së mjeteve nga përmbaruesi. Kryetari vazhdimisht në vitin e kaluar është ankuar se na janë marr shumë mjete nga përmbaruesi dhe shumë kërkesa të qytetarëve kanë mbete pa u realizuar shkaku i mungesës së mjeteve. Në këtë raport askund nuk ceket shuma e mjeteve qe i janë marrë komunës nga përmbaruesi. Po ajo që është shumë me rëndësi që ta din qytetarët është fakti që përkundër krizës financiare që e ka kapluar komunën, komuna nuk i ka ndalur aspak shpenzimet e luksit, ku vetëm për dreka kodi 14310 janë shpenzuar hiq më pak se 49,113.56 euro, kurse për udhëtime jashtë vendit janë shpenzuar 54,471.43. A mund ta dimë ne dhe qytetarët e Vushtrrisë se cilat ishin përfitimet e komunës nga këto shpenzime?

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –tha se ky raport për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024, është dëshmia më e mirë se si është qeverisur Komuna e Vushtrrisë gjatë viti të kaluar. Fatkeqësisht kemi parë një performancë të tmerrshme në aspektin e pasqyrave financiare dhe mos arritjen në destinimin e duhur të mjeteve financiare gjatë viti 2024. Kjo për faktin se jo vetëm marrja e mjeteve nga përmbaruesit privat por edhe mos realizimi i shpenzimeve për investime kapitale e kanë bllokuar zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë. Tutje duke ju adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, njoftoj se kuvendi i komunës ka marr vendim për subvencionimin e litrës së qumështit me 5 centë për fermerët prodhues të qumështit por kjo pagesë nuk është realizuar në vitin 2024. Po ashtu Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka herë ka marr

vendim për pagesën e subvencioneve për fëmijët e porsalindur por as kjo pagesë nuk është bërë gjatë viti 2024, shtu këtu faktin se edhe kiflet për nxënës janë hequr, kjo tregon se performanca e komunës ka qenë larg të dëshiruarës. Me i ndal kiflet për fëmijët e me i rritë shpenzimet për drek dhe darka të zyrtarëve komunal kjo vërtet është e tmerrshme. Kryetari i komunës ka bërë shpenzime të jashtëzakonshme për dreka dhe darka fillimisht duke ju paguar iftare kujt ka mundur dhe kënd e ka takuar, më pas duke ju paguar dreka zyrtarëve të komunës mësimdhënësve stafit shëndetësor e të ngjashme të gjitha këto në dëm dhe kurriz të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë. Ajo çka është e dhimbshme është fakti se në tablat e buxhetit kemi dhjetëra e qindra projekt që janë votuar në kuvend e asnjëherë nuk janë përfunduar dhe kurrë nuk dihet për fatin e këtyre projekteve në ndërkohë që paratë janë shpenzuar por për destinime tjera. Prandaj i bëri thirrje kryetari të komunës që ti përmbush të gjitha obligimet e marr për subvencione nga viti paraprak, pra le ti paguaj obligimet prej 120 € për fëmijët e paslindur, le ti paguaj shumat prej 0.5 cent për litër të qumështit për fermerët e Komunës së Vushtrrisë, le ti kthej kiflet për nxënësit e Komunës së Vushtrrisë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –tha se është përgjegjësi që drejtorët e drejtorive komunale vinë vetë në fillim të mbledhje sa për tu fotografuar e më pas ata e lëshojnë mbledhjen duke mos ndjerë kurrfarë përgjegjësie për funksionet që i mbajnë. Pastaj shtoj pyetjen se si qeverisi kryetari Ferit Idrizi komunën në vitin 2024 është pyetje që dëshirojnë ta dinë qytetarët dhe përgjigjja është se ai qeverisi keq dhe në dëm të qytetarëve. Ai vlerësoi se pati tentativa për të kontrabanduar dhe gllabëruar tokat publike, respektivisht për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale për individ dhe për dy partitë që janë këtu. Në vitin 2024 vazhdoj tradita e ndërrimit të drejtorëve të drejtorive. Premtim i kryetari të komunës që brenda 6 muajve do të kemi ujë të pijes nuk u realizuar as në vitin 2024. Viti 2024 ishte vit i ngecjes të zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë dhe dështim i menaxhimit të financave publike, ku deri në muajin tetor kemi pasur mbi 4 milion euro të pashpenzuara për investime kapitale dhe shumë projekte nuk kanë filluar ende. Shpenzime e shumta të kësaj qeverie janë drekat, darkat dhe shpenzimet jashtë vendit me paratë e taksapaguesve nga komuna jonë duke mos ju sjellë asnjë të mirë të vetme qytetarëve të komunës së Vushtrrisë. Pyeti cilat janë të mirat që do ti sjellë kryetari i komunës nga vizita në Britaninë e Madhe që ndodhet aktualisht. Arsimi në komunën tonë gjatë viti 2024 është karakterizuar me ngecje të mëdha, konkurse të dirigjuara, anulim të konkurseve, rënie të suksesit të nxënësve, mungesa të nxënësve dhe mësimdhënësve. Deri në muajin tetor 2024 nga 19 projekte në arsim vetëm 2 projekte janë zhvilluar dhe realizuara, për më tepër kryetari i komunës ka premtuar se një pjesë mjeteve që dalin nga kontrata kolektive ti ekzekutojë në muajin dhjetor por kjo nuk ka ndodhur. Fermerëve të komunës ju ka premtuar përkrahje financiare 05 cent për litër të qumështit po nuk e ka realizuar gjatë viti 2024. Si komunë nuk keni respektuar Udhëzimin Administrativë për pagesën e kryetarëve të Këshillave Lokal, edhe për kundër se ata po bëjnë një punë të shkëlqyeshme prej vendeve kah vinë. Nuk është bërë subvencionim i fëmijëve të porsalindur dhe i të sëmurave. Në fund tha se akoma kemi projektet të planifikuara me nga 5 cen, 10 dhe 50 cent që janë projektet absurd, ndërsa shtoj se parat e taksa pagesve janë shpenzuar kurse punët në teren nuk janë kryer.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti** sqarime të përgjithshme lidhur me raportin vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024, duke iu përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” aprovoj Raportin vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.**

4. Kërkesë për mbështetje financiare për shërim për z. Adem Hasani.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim z. Adem Hasani, nga fshati Ropicë i ndahen mjete financiare në shumë prej tremijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë euro (3,760.00 €), ndihmë financiare për shërim.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Zyra e Kryetarit të Komunës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 16024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se këtë vendim gjithsesi që e përkrahin kur është fjala për zyrtarë e komunës, por ceku se mënyra se si është sjellë ky vendim në kohë elektorale është për keqardhje.

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit** –tha se nëse një propozim është për keqardhje atëherë ati nuk duhet ti japim pozitivitet. Ai propozoi që nga ky vendim të hiqen anëtarë e kuvendit dhe i njëjti të aprovohet.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –propozoi që në kuadër të këtij vendimi të hiqen anëtarët e kuvendit dhe të shtohen familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranët dhe familjet me asistencë sociale, sepse të hyrat e këtyre familjeve janë më të ulët se sa të hyrat e zyrtarëve të administratës së komunës. Duke pasur për bazë faktin se LVV është parti e majtë që i përkrah politikat sociale e mbështesim këtë propozim-vendim.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –tha se bazuar në rregulloren e kuvendit ky propozim-vendim ose duhet të votohet ashtu siç ka ardhur ose duhet të hedhet poshtë të refuzohet por nuk kemi të drejtë për kundërpropozime për të njëjtën çështje.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se është këto një kandidat një subjekt politikë që në bashkëpunim me listën serbe kanë votuar në parlamentin e Kosovës për hequr nga paga minimale veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Tani të njëjtit njerëz këtu shesin moral, por populli e di se për këto kategori vendos Kuvendi i Kosovës e jo komuna, por kjo është vetëm sa për shitur moral dhe për tentuar të thonë diçka për përfitime elektorale dhe zgjedhore.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-njoftoi duke sqaruar se edhe para një viti e më tepër kishte propozuar se kjo është forma e vetme që punëtorëve të administratës do të mund tu dalim në ndihmë, sepse vendim për shujtat është ditur se nuk kalon dhe i njëjti nuk do të aprovohet nga ana e ministrisë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100.00 € (njëqind euro) me rastin e festës së Fiter Bajramit, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga fondi 10, kodi i programit (16024), kategoria: subvencione dhe transfere (200) - Zyra e Kryetarit.
3. Pjesë e këtij vendimi do të jetë lista e punëtorëve të Administratës së Komunës dhe anëtarëve të kuvendit të komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Prokurim Publik, Drejtoria për Buxhet e Financa, dhe Zyra e Personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
6. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.216/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 216/24 i datës 02.12.2024, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh** bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
7. Rishqyrtimi dhe harmonizimi i vendimit me numër të protokollit 01.196/24 i datës 31.10.2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, për KEDS-in.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202021-000519-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm e cila përfshinë një sipërfaqe prej 14.84m<sup>2</sup> të marr nga sipërfaqja e përgjithshme 3132.3m<sup>2</sup> pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe prona e paluajtshme e Komunës së Vushtrrisë e cila gjendet në ngastrën kadastrale me nr.P-70202021-00575-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm e cila përfshinë sipërfaqe prej 16.85m<sup>2</sup> të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10053m<sup>2</sup>, në shumën prej 200 euro/copë.

2. Ngastrat kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite KEDS-it, për vendosjen e trafostacionit shpërndarës (blind) në sipërfaqe prej 4.00 X 3.00 m<sup>2</sup> dhe 4.00 X 4.00m<sup>2</sup>.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Pjese përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat e pronësisë, kopja e planit, skicat e projektit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Propozim - vendim për dhënien në menaxhim të Qendrës për Grumbullim Riciklim dhe Paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 26 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, NPL “Përparimi” SH.A në Vushtrri i ipet në menaxhim në kohë të pacaktuar Qendra për grumbullim riciklim dhe paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh, Komuna Vushtrri, pronë e paluajtshme e Komunës e regjistruar si vijon:

1.1 Pjesa e ngastrës kadastrale nr. 70202010-0, në sipërfaqe prej 10000 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Bukosh,

1.2 Objekti në sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup> i ndërtuar në ngastrën e cekur në nënparagrafin paraprak,

1.3 Pajisjet: një makinë transportuese shpërndarëse (pikap kamionetë), një kamion për grumbullimin e mbeturinave, një shirit transportues, dy peshore matëse, një vinç i motorizuar, një vinç manual, katër makina balluese si dhe 100 (njëqind) kontejnerë të shpërndarë në terren për riciklim të mbeturinave.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të kësaj Qendre është funksionalizimi i saj përkatësisht fillimi i ushtrimit të aktiviteteve nga NPL “Përparimi” SH.A për grumbullimin riciklimin dhe paketimin e mbetjeve të riciklueshme duke qenë se kjo qendër dhe pajisjet e kësaj qendre nuk janë shfrytëzuar me vite të tëra për shkak të mungesës së stafit menaxhues – punues, e gjithë kjo në funksion të ekonomisë qarkore.

3. Obligohet Kryetari i komunës që pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të lidhë marrëveshje me Kryeshefin Ekzekutiv të NPL “Përparimi” në Vushtri me të cilën do të përcaktohen detajet e dhënies në menaxhim të Qendrës për grumbullim, riciklim dhe paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Propozim - vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit**-propozoi për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Adnan Lahu nga radhët e LDK-së.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 20 vota “për” 4 votë “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.04/22 i datës 14.01.2022 lidhur me themelimin e Komiteti për Politikë dhe Financa ashtu që në vend të z. Alban Bajrami nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) emërohet z. Adnan Lahu, nga i njëjti subjekt politik.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:50**

**Bastri Duraku**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Procesmbajtës**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

	<b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police	
	Drejtoria Rajonale e Policisë / Mitrovicë Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate Stacioni Policor Vushtrri Policijska Stanica Vučitern / Police Station Vushtrri	

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

<b>PËR:</b> <b>ZA:</b> <b>TO:</b>	z.nj Melihate Basholli/Latifi Kryesuese e kuvendit komunal Vushtrri	<b>Data:</b> <b>Datum:</b> <b>Date:</b>	04.02.2025
<b>PËRMES:</b> <b>PREKO:</b> <b>THROUGH</b>	Direkt	<b>Nr. i Referencës:</b> <b>Br. Referencije:</b> <b>Reference No:</b>	05/1-03 VSH-K / 023/ 25
<b>PREJ:</b> <b>OD:</b> <b>FROM:</b>	Kapiten Reshat Kovaçi Komandant i Stacionit Stacioni Policor Vushtrri		
<b>LËNDA:</b> <b>PREDMET:</b> <b>SUBJECT:</b>	Informatë mbi gjendjen e sigurisë në zonën e përgjegjesisë së komunës së Vushtrrisë për vitiin 2024		

E nderuar Kryesuese z.nj Basholli/Latifi.

- Për gjatë gjithë vitit 2024 situata e sigurisë në zonë e përgjegjesisë të Stacionit Policor Vushtrri ka qenë e mirë dhe stabile. Gjatë vitit 2024 numri i rasteve në total ka qenë 1147 që në krahasim me vitin 2023 ka një rënie prej 1.8%. Tek veprat penale është shënuar një rritje e veprave penale në krahasim me vitin e kaluar prej 4.2% sidomos për shkak të rritjes së rasteve “Lëndim i lehë trupor” dhe “Dhuna në familje”. Është arritur sukses në zbulueshmëri të rasteve në total prej 76.5%.
- Angazhimet tona dhe veprimet e zyrtarëve Policor janë të fokusuar në parandalimin e veprave kriminale dhe në zbulimin e rasteve. Bashkëpunimi ndër institucional ka qenë në vazhdimësi të mirë dhe i bashkërenditur me gjitha institucionet, organizatat jo qeveritare, dhe të gjithë akteret që ndihmojnë në siguri.
- Gjatë vitit 2024, në zonën e përgjegjesisë së Vushtrrisë nuk ka pasur të raportuar asnjë rast me motive ndëretnike.
- Tek siguria e përgjithshme gjatë vitit 2024, sigurisht se ka ndikuar edhe angazhimi i pjesëtarëve të SP-Vushtrri të cilët kanë qenë të angazhuar edhe kanë asistuar edhe jashtë zonës së përgjegjesisë së Stacionit Policor Vushtrri si në veri të vendit si angazhime shtesë.

- Trajtimi i geneve endacak nuk ka qene ne nivelin e kërkuar, rrjedhimisht kemi pas raste te kafshimit nga genet endacak, ku janë evidentuar 8 raste. Këto raste po vazhdojnë te shqetësojnë ne mase te madhe qytetaret.

- Siguria në Trafikun rrugor:

Tek siguria në trafik kemi pas një angazhim të shtuar në parandalimin e aksidenteve dhe në sensibilizimin e pjesëmarrësve në trafik në lidhje me fillimin e zbatimit të ligjit të ri të trafikut ku ka rritje të gjobave për kundërvajtje në trafik ,gjitha këto kanë arrit që numri aksidenteve në trafik krahasuar me vitin 2023 ka pas një rënie prej 13.5 % .Kemi pas shumë pika kontrolli si në brendi të qytetit edhe në rrugët nacionale dhe rurale për vetëdijesim e qytetarëve rreth respektimit të ligjit dhe respektimin e shenjave të komunikacionit. Janë shqiptuar 6760 tiketa për kundërvajtje .

Trafiku në këtë vit në rrugën nacionale dhe rrugët në qytet kanë pas një ngarkesa më të madhe kryesisht për shkak te punimeve në zgjerimin rrugës nacionale si dhe në brendi të qytetit ku janë kryer punime të shumë rrugëve , si rrugët „ Lumni Surdulli” punimet në shesh (Parkingut nëntokësor) „Arsim Muzaqi” si dhe „Ukshin Kovaçica” . Kemi vazhduar qe te kemi prezencë policore ne sheshe dhe ne rrugët peretth qendrës se qytetit.

Komuna duhet te krijoj sistem te menagjimit te parkingjeve ne qytet ne mënyrë qe te mundësohet qarkullim me i mire i veturave dhe këmbësoreve.

- Veprat penale kundër narkotikëve:

Aktivitetet e zyrtarëve policor kanë qen të shtuara rreth parandalimit dhe arrestimit të personave që merren me narkotik si përdorues ashtu edhe me shitblerje .Patrullimet e shtuara kanë qen rreth shkollave kryesisht të mesme si dhe në lokacione të ndryshme nëpër qytet , në shëtitoren „ Enver Zymberi “ tek Studioni i Hendbollit e lokacione tjera . Gjatë vitit 2024 kemi pas 41 raste për posedim të narkotikëve dhe gjatë aktiviteve zyrtarët policor kanë arritur të arresojnë 45 persona për posedim të narkotikëve dhe janë proceduar para organeve të drejtësisë. Fokusi i ynë do jetë parandalimi i kësaj dukurie që sjell dëme sidomos tek gjeneratat e reja.

- Rastet e dhunës në Familje:

Rastet e dhunës në familje kanë shënuar ngritje gjatë vitit 2024, në krahasim me vitin paraprak për 38.7%. Edhe për kundër sensibilizimit të opinionit kundër këtyre rasteve , është numë i madh i rasteve që si dukuri po na përcjell . Zyrtarët policor reagues dhe hetuesit e rasteve të dhunës në familje këto raste i kanë trajtuar me prioritet dhe përgjegjësi, profesionalizëm dhe kujdes të shtuar bazuar në ligjin përkatës .Mbetet që edhe shoqëria jonë edhe institucionet tona të bëjmë më shumë rreth parandalimit të këtyre rasteve .

- Siguria në Shkolla:

Siguria në shkolla ka qen në nivel të mirë të sigurisë edhe vitin 2024 , kemi punuar në bazë të planit Operativ Siguria në shkolla ku zyrtarët e angazhuar rreth shkollave kanë bërë një punë të mirë në ofrimin e një ambienti sa me te sigurt për nxënësit dhe personelin e shkollave. Bashkëpunimi i mirë mes drejtoreve të shkollave dhe zyrtarëve kanë dhen rezultate në sigurinë e mirë që kemi në gjitha shkollat e qytetit. Puna e zyrtarëve të angazhuar ka pas në fokus parandalimin e incidenteve në shkolla



dhe rreth tyre. Në kuadër të angazhimeve rreth shkollave gjatë vitit 2024 kemi zbatuar dy kontrolle në gjitha shkollat që kanë pas për qëllim eliminimin e çdo dukurie negative tek nxënësit sidomos, përdorimit të narkotikëve dhe bartjeve të armëve .Gjatë vitit kemi zhvilluar ligjërata vetëdijesimi në shumë shkolla për ndërgjegjësimin e tyre rreth dukurive negative në shoqëri . Bashkëpunimi i mirë me drejtorët dhe mësimeve do vazhdojë dhe gjendja e sigurisë do jetë gjithnjë më e mirë .

- Objektivat policor për vitin 2025

Fokusi kryesor i Policisë në përgjithësi mbetet Parandalimi dhe zbulimi i krimit. Përmirësimi i gjendjes në trafikun rrugor, mbeten ndër sfidat e Policisë, respektivisht të stacionit policor në Vushtrri.

Me respekt!



Republika e Kosovës








Kuvendi i Komunës – Vushtrri

**Për KPF-në dhe Kuvendin e Komunës**

**Propozues: kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi** 

**Hartues: Komisioni Komunal për Mirënjohje dhe Dekorata:**

1. Izet Miftari 
2. Alban Tahiraj 
3. Medina Bunjaku 
4. Blerim Ibrahimimi 
5. Isak Hyseni 

**Tema: Propozim-vendim**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 6 të Rregullores 01Nr.209/20 e datës 29.10.2020 për Dhënie e Dekoratave, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: \_\_\_\_\_ **2025**, merr këtë:

**VENDIM  
PËR DHËNIEN E TITULLIT “NDERI I QYTETIT”**

1. Me këtë vendim, më datë 24 mars “ditës së rënies”, me titull “Nderi i qytetit” (post mortum), nderohet z. Latif Berisha, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, duke u bërë frymëzim për brezat e ardhshëm.
2. Dorëzimi i kësaj dekorate (titullit) do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 24 mars 2025 “ditës së rënies”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

\_\_\_\_\_  
**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Duke e çmuar shumë personalitetin e prof. Latif Berishës për kontributin e dhënë në çështjen kombëtare, i propozojmë Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë që t'i ndahet Dekorata (postmortum) "Nderi i Qytetit".

Dekorata do t'i dorëzohet familjes së prof. Latif Berishës, më 24 mars 2025, me rastin e 26 të vrasjes së tij nga forcat pushtuese serbe.

Më poshtë është e bashkangjitur edhe një biografi për prof. Latif Berishën.

**LATIF BERISHA**, u lind në fshatin Smrekonicë të Vushtrrisë në vitin 1931. Shkollën fillore e mbaroi në Vushtrri, ku më 1948 nga Gjimnazi i Ulët së bashku me disa shokë do të vlerësohet dhe do të bëhet mësues në Pantinë. Në vitin 1954 në Beograd studioi Gjuhë e Letërsi Shqipe. Atje, gjatë kohës së studimeve, do t'i prijë Shoqatës së Studentëve Shqiptarë "Përpjekja". Një vit më vonë do t'i përgjigjej thirrjes së drejtorit të Gjimnazit të Ulët Shqiptar në Vushtrri, Burhan Badivuku dhe bashkë me kolegët e tij Nuri Bashota, Hamdi Kasapolli, Muhamet Sylqe, Kadri Kusari, Hamit Boshnjaku, etj. do të plotësojë mungesën e arsimtarëve.

Në këto rrethana profesor Latif Berisha me shokë, përveç mësimin në Gjimnaz, do të shkelë fshat më fshat duke i bindur shqiptarët që të mos shpërngulen për Turqi. Prania e tij me shokë në fshatrat e rrethinave të Vushtrrisë ishte forcë e madhe në këtë kohë të synimeve serbe për pastrimin etnik të Kosovës. Në vitin 1957 profesor Latif Berisha botoi përmbledhjen e vjershave "Tufa".

Pas diplomimit Latifin e gjejmë profesor të Gjuhës shqipe në Gjimnazin e Mitrovicës deri në vitin 1967, kur kalon profesor në Fakultetin Filozofik - Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë, ku ligjëroi për përpjekjet letrare dhe kombëtare të rilindësve tanë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Në vitet e '90 të shekullit të kaluar ishte prijatar i Lëvizjes Demokratike në mbrojtjen e qenies kombëtare shqiptare. Ishte përherë pranë profesor Anton Çetës dhe studentit të vet, kryetarit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova. Si veprimtar politik ishte kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Mitrovicë nga themelimi e deri sa u masakrua nga kriminelët serbë, më 24 mars 1999.

Në kujtesën e shumë brezave të nxënësve që nga shkolla fillore dhe e mesme si dhe nga fakulteti profesor Latif Berisha do të mbetet engjëlli i dijes dhe pishtari i ndritur e i devotshëm i arsimit shqip.

Për punë cilësore në procesin mësimor, duke filluar nga shkolla fillore e deri te katedra universitare, ai do të nderohet shumë herë me mirënjohje e shpërblime të shumta. Por, siç thoshte ai, sa ishte në jetë vetë, se mirënjohjet dhe shpërblimi më i mirë për mua është suksesi i arritur i arsimit shqip në përgjithësi. Në vitin 2015, profesor Latif Berishën, pas vdekjes, për kontributin e dhënë arsimit shqip, në veçanti atij universitar, edhe Shoqata Veteranët e Arsimit "Hasan Prishtina", për nder të 100 Vjetorit të Shkollës Shqipe në Vushtrri, do ta nderojë me *Mirënjohje*.

Izet Miftari

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA- VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT KOMUNALE PËR DEKORATA MBAJTUR MË  
13 SHKURT 2025**

Mbledhja është mbajtur në sallën e konferencave në objektin e Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **14:00**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e komisionit Izet Miftari, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Ri dhe Sport, Albanez Tahiraj, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, Medina Bunjaku, Drejtoresh e Drejtorisë për Diasporë Isak Hyseni dhe Blerim Ibrahimimi nga shoqëria civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Izet Miftari Kryesuese i komisionit i cili konstatoj se kemi kuorumi të plotë për vendimmarrje dhe prezantoi rendin e ditës.

Pas shqyrtimit komisioni me vota “unanime” aprovoj këtë:

**R E N D I T E**

- 1. Shqyrtim i propozim-vendimit për dhënien e titullit (dekoratës) “Nderi i Qytetit” prof. Latif Berishës (psot mortum).**

**Izet Miftari, kryesues i Komisionit-** deklaroi se ky propozim-vendim është i qëlluar dhe meritor që prof. Latif Berishës ti ndahet titulli “Nderi i Qytetit”. Pastaj lexoj para komisionit biografin e prof. Latif Berishës.

**Blerim Ibrahimimi, anëtar i komisionit-** deklaroi se pajtohet me një propozim të tillë, dhe e vlerësoi lartë personalitetin e Latif Berishës.

Pas diskutimeve, kryesuesi i komisionit e hodhi në votim propozim-vendimin për dhënien e titullit (dekoratës) “Nderi i Qytetit” prof. Latif Berishës (post mortum) dhe me vota “unanime” u vendos që ky propozim të procedohet në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në ora: **14:30**.

**Bastri Duraku**

  
Procësbajtës

**Izet Miftari**

  
Kryesues i Komisionit



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës Vushtrri

Propozuesi :Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi 

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Remzi Ahmeti 

Lënda: Propozim-Vendim për lirim nga qiraja

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2025, mori këtë:

## V E N D I M

### **Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022, 2023 dhe 2024 e lokaleve pronë komunale në Sheshin "Adem Jashari"**

1. Lirohen nga qiraja për vitin 2022, 2023 dhe 2024 pronarët në shfrytëzim të lokaleve pronë komunale.
  - 1.1 Aziz Kolla qiramarrës i lokalit nr. 136
  - 1.2 Fatmir Durguti qiramarrës i lokalit nr. 138
  - 1.3 Ahmet Tërllabuqi qiramarrës i lokalit nr. 140
  - 1.4 Zeqir Mulaku qiramarrës i lokalit nr.142
  - 1.5 Naim Jetullahu qiramarrës i lokalit nr.144
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


**Kryesuese e Kuvendit**

\_\_\_\_\_  
Melihate Basholli-Latifi

## ARSYETIM

Pronarët e lokaleve komunale të cilat i posedojnë me qira nga komuna, kanë parashtruar kërkesë me nr.02-104/01-0052751/24 me të cilën kanë kërkuar që tu falen borgjet e qirasë pasi kanë pasur pengesa në realizimin e veprimtarisë së tyre për shkak të punimeve në “Sheshin Adem Jashari”. Konsiderojmë se falja e borgjt - lirit nga qiraja për periudhën 2022-2023-2024 është e arsyeshme për shkak se në Sheshin “Adem Jashari” janë kryer punime për rreth lokaleve apo në afërsi të tyre, dhe për shkak të këtyre punimeve nuk kanë mundur të realizojnë veprimtarin e tyre si duhet.

**Udhëheqësi i Sektorit për Pronë**



Azem Bejta

**Drejtori i Drejtorisë**



Remzi Ahmeti



## Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia  
Kryetari i Komunës

Data 30/10/2024

## 1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Zeqir Mulaku

Numri personal

1005101677

Adresa e vendbanimit

Vushtrri

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44332466

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mës shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

02-104/01-0052751/24

Afati i zgjedhjes

29/11/2024

Vendimi

## 3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese

## 4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

## 5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Zeqir Mulaku vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Iridon Krasniqi

Kërkesë nga zejtarët e sheshit Adem Jashari

Për: Kuvendin Komunal Vushtrri

Të nderuar,

Ne zejtarët që operojmë në sheshin Adem Jashari dëshirojmë të shprehim falënderimet tona të sinqerta ndaj Komunës së Vushtrrisë për ndihmën e ofruar gjatë periudhës së pandemisë 2020/21, kur u liruar nga qiraja për lokalet tona. Megjithatë, që nga viti 2021 nuk kemi marrë asnjë njoftim zyrtar mbi vazhdimin e pagesave, deri në javën e kaluar, kur morëm një njoftim për grumbullimin e borxhit për vitet 2022/23 dhe 2024.

Jemi të vetëdijshëm për nevojën e shlyerjes së borxhit, por me mirësjellje kërkojmë mirëkuptimin tuaj në lidhje me kërkesën tonë të përbashkët. Puna në lokalet tona ka pësuar një rënie të konsiderueshme, ndoshta të njohshme, si pasojë e punimeve në shesh. Prandaj, ne lutemi që të na lehtësoni nga qiraja për periudhën [redacted] deri në përfundimin e tyre, kështu që ne të mund të vazhdojmë me aktivitetet tona si më parë.

2022,  
2023  
2024

Nëse kjo nuk është e mundur, do ishim mirënjohës nëse do të na mundësonit të zvogëlohej qiraja ose të bëjmë pagesa në këste të përballueshme.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe jemi të gatshëm për të diskutuar këtë çështje më tej.

Nga

Emri

Mbiemri

Nënshkrimi

Nr. i letërnjoftimit

Aziz	Kolla		1003980720
FATMIR	DURGUTI		1030045447
AHMET	TERLLABUQI		1004749851
ZEJIR	MULAKU		1005101677
NAJIM	DETULLI		1021282947








REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>DATË:</b>	<b>29.01.2025</b>
<b>PËR:</b>	<b>KPF dhe Kuvendin e Komunës</b>
<b>NGA:</b>	<b>Zdravko Zdravković</b>  <b>Kryesues i Komitetit për Komunitete</b>
<b>LËNDA:</b>	<b>Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete për vitin 2024</b>

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Raportin Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Me respekt!

## RAPORTI VJETOR I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024 KOMUNA E VUSHTRISË

### HYRJE

Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej 12 takime, të cilat janë organizuar çdo muaj, përveç muajit gusht, i cili ishte planifikuar për pushime. Në muajin tetor, Komiteti organizoi edhe dy takime, duke rritur kështu dinamikën e punës dhe duke përfshirë një gamë të gjerë çështjesh të rëndësishme që prekin të gjitha komunitetet në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Gjatë këtij viti, Komiteti ka vazhduar të përqendrohet në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të drejtave të komuniteteve pakicë, zgjidhjen e problemeve të tyre, si dhe bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat përkatëse. Të gjitha takimet kishin për qëllim forcimin e koordinimit të ndërsjellë dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për sfidat me të cilat përballen komunitetet e ndryshme, veçanërisht ato pakicë, me qëllim arritjen e barazisë dhe kohezionit social.

### JANAR 2024

Komiteti për Komunitete i Komunës së Vushtrrisë mbajti mbledhjen e parë të vitit 2024, duke u përqendruar në shqyrtimin e Raportit të Punës për vitin 2023 dhe planifikimin e aktiviteteve për përmirësimin e punës gjatë këtij viti.

U arrit përfundimi që raporti të miratohet, në mënyrë që të mundësohet përqendrimi në planet për vitin 2024, duke u theksuar nevoja për të analizuar dhe eliminuar mangësitë nga viti i kaluar. Komiteti përfundoi se janë të nevojshme përpjekje shtesë për përmirësimin e punës në fushat ku janë identifikuar probleme gjatë vitit 2023. U vu theksi i veçantë në nevojën për të shtuar vizitat në komunitete dhe për të mbledhur në mënyrë më efektive kërkesat e qytetarëve.

Gjithashtu, u arrit përfundimi se është e domosdoshme përfaqësimi i të gjitha komuniteteve. U dakordua që të organizohen vizita familjare për familjet në situata të vështira, për të cilat është e nevojshme të përpilohet një listë e familjeve në kushte të rënda ekonomiko-sociale. Po ashtu, do t'i bëhet apel autoriteteve lokale për të siguruar logjistikën e nevojshme për këto aktivitete.

### KONKLUZION

Komiteti për Komunitete i Komunës së Vushtrrisë e nisi me sukses punën në vitin 2024, duke miratuar Raportin e Punës për vitin 2023. Vëmendja u përqendrua në identifikimin dhe tejkalimin e problemeve nga viti i kaluar, me një fokus të qartë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë në përmirësimin e pozitës së komuniteteve jo shumicë në Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit 2024.

## SHKURT 2024

### HYRJE

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vushtrrisë u mbajt me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Punës për vitin 2024, si dhe trajtimin e çështjeve të hapura që lidhen me të drejtat dhe nevojat e komuniteteve jo shumicë. Fokus i veçantë iu kushtua përmirësimit të mekanizmave për realizimin e të drejtave të komuniteteve dhe planifikimit të aktiviteteve për muajt në vijim.

Plani i propozuar i Punës për vitin 2024 përfshiu aktivitete mujore, nga analizimi i raporteve vjetore dhe diskutimet e hapura mbi temat si bujqësia, ekologjia, punësimi i të rinjve, deri te vizitat tek familjet në kushte të vështira dhe shqyrtimi i të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Diskutimi përfshiu këto konkluzione:

- Plani i Punës duhet të jetë fleksibil dhe të lejojë trajtimin e temave aktuale që nuk janë parashikuar.
- Duhet vazhduar përpjekjet për përfaqësimin e të gjitha komuniteteve dhe sigurimin e mbështetjes nga organizatat joqeveritare dhe institucionet ndërkombëtare për realizimin e projekteve.
- Vëmendje e veçantë iu kushtua çështjeve të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Komiteti miratoi njëzëri Planin e Punës për vitin 2024.

- Është e nevojshme intensifikimi i bashkëpunimit me Zyrën për Komunitete dhe Kthim për të adresuar më me efikasitet çështjet me rëndësi për komunitetet.
- Institucione si UNMIK-u dhe OSBE-ja u ftuan të mbështesin projektet për komunitetet jo shumicë. UNMIK-u informoi se është hapur një thirrje publike për projekte deri në vlerën 25,000 euro, me qëllim ndërtimin e besimit, ndërsa afati për aplikim është 22 mars.
- Theks i veçantë iu kushtua hartëzimit të familjeve në situatë të vështirë social-ekonomike për t'u ofruar ndihmë adekuate.

### KONKLUZION

Komiteti për Komunitete të Komunës së Vushtrrisë miratoi me sukses Planin e Punës për vitin 2024 dhe vendosi themelet për realizimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve jo shumicë. Fokusi do të jetë te bashkëpunimi me akterët lokalë dhe ndërkombëtarë, si dhe te monitorimi i vazhdueshëm i respektimit të të drejtave të të gjitha komuniteteve në komunë.

## MARS

### 1. Vendimet lidhur me rendin e ditës

Për shkak të mungesës së përfaqësuesve nga Drejtoria e Bujqësisë, anëtarët e Komitetit vendosën njëzëri që pika e rendit të ditës lidhur me subvencionet të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. U theksua rëndësia e koordinimit më të mirë dhe caktimit të temave me kohë.

### 2. Diskutimet mbi çështjet aktuale

- **Subvencionet për bujqësinë:** U raportua për ngarkesë të madhe të zyrtarëve gjatë procesit të subvencionimit, duke vështirësuar komunikimin e qytetarëve me Drejtorinë. U propozua angazhimi i stafit shtesë për të lehtësuar presionin dhe për të përmirësuar efikasitetin.
- **Problemet ekologjike:** U raportua për bllokimin e lumit Silnica pranë fshatrave Glavotinë dhe Prilluzhë, si pasojë e hedhjes së mbeturinave, duke paraqitur një rrezik të mundshëm nga përmytjet. Gjithashtu, u theksua pastrimi i parregullt i shtratit të lumenjve dhe mungesa e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e mjedisit. U rekomandua veprim i shtuar i inspektoratit komunal dhe nxitja e sjelljes së përgjegjshme të qytetarëve.
- **Problemet me grumbullimin e mbeturinave:** Në disa fshatra të Komunës së Vushtrrisë, megjithëse qytetarët paguajnë për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, shërbimi nuk ofrohet. U propozua dhënia e rekomandimeve për zgjidhjen e këtij problemi.

### 3. Propozimet për aktivitetet e ardhshme të Komitetit

- U propozua që në kuadër të Komitetit të formulohet një plan i aktiviteteve dhe të kërkohen fonde buxhetore për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.
- U theksua nevoja për bashkëpunim më të madh me përfaqësuesit e Komunës në zgjidhjen e problemeve aktuale.
- U planifikua që muajin e ardhshëm anëtarët e Komitetit të vizitojnë familjet në situatë të vështirë ekonomike, me rekomandimin që anëtarët të ndahen në grupe për realizimin më efikas të vizitave.

## KONKLUZION

Komiteti për Komunitete vazhdon të fokusohet në zgjidhjen e problemeve kryesore të komunitetit, me theks të veçantë në sfidat ekologjike, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe mbështetjen e familjeve në nevojë sociale. Në periudhën e ardhshme, planifikohet intensifikimi i aktiviteteve dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet lokale.

## **PRILL 2024**

### **1. Diskutimi mbi subvencionet për bujqësinë**

- Afati për aplikim për subvencione është zgjeruar që të gjithë fermerët e interesuar të kenë mundësinë të paraqesin kërkesat e tyre.
- Drejtoria e Bujqësisë ka futur një sistem për caktimin e terminëve për aplikim, duke reduktuar ndjeshëm mundësitë për grumbullime dhe pritje.
- Është propozuar mundësia e aplikimit online përmes platformës e-Kosova për të lehtësuar procesin për qytetarët.
- U ngritën pyetje lidhur me kriteret specifike për subvencionet, përfshirë sipërfaqen minimale të tokës për serat dhe kërkesën për posedimin e certifikatës së fermerit.

### **2. Vizitat tek familjet në kushte të vështira ekonomike**

Anëtarët e Komitetit vizituan disa familje në Komunën e Vushtrisë, të cilat përballen me kushte të vështira sociale dhe ekonomike:

- Një familje në Prelluzhë, me probleme serioze shëndetësore, ka nevojë urgjente për ndihmë për ndërtimin e një shtëpie dhe për nevojat themelore higjienike.
- Dy familje në Stanofc dhe Vushtri u cilësuan si prioritet për ndihmë të shtuar për shkak të kushteve tepër të vështira.
- U propozua që prioritet t'u jepet familjeve me nevojat më të mëdha, ndërkohë që për familjet e tjera do të mund të sigurohet mbështetje shtesë përmes bashkëpunimit me organizata dhe donatorë.

### **3. Problemet me infrastrukturën publike**

- Mungesa e ndriçimit publik në fshatin Gojbulë dhe në rrugën Prelluzhë - Plemetin është identifikuar si një problem serioz. U rekomandua që kjo çështje të diskutohet me autoritetet lokale për të gjetur një zgjidhje.
- Probleme të ngjashme me ndriçimin u vërejtën edhe në pjesë të tjera të komunës, të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e kuvendit të komunës.

### **4. Konkluzionet dhe planet për periudhën në vijim**

- U propozua forcimi i fushatave informuese për qytetarët, që ata të jenë më mirë të informuar për subvencionet dhe kriteret për aplikim.
- Komiteti do të vazhdojë vizitat te familjet në kushte të vështira dhe do të punojë në koordinimin e ndihmës.
- Do të vazhdohet puna për zgjidhjen e problemeve me infrastrukturën publike duke përfshirë shërbimet e nevojshme komunale.

## KONKLUZION

Komiteti për Komunitetet vazhdon aktivitetet e tij të orientuara në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët, zgjidhjen e problemeve me infrastrukturën dhe mbështetje për familjet në nevojë sociale. Në periudhën e ardhshme, fokusi do të jetë në përmirësimin e bashkëpunimit me autoritetet lokale dhe angazhimin e burimeve të tjera për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

### MAJ 2024

#### 1. Problemet me shërbimet komunale dhe mbeturinat

- Në një lagje në Prelluzhë është identifikuar një problem me grumbullimin e mbeturinave në dy rrugë, ku kompania për mbledhjen e mbeturinave nuk ofron shërbim, megjithëse qytetarët paguajnë rregullisht. Përdoruesve u është shpjeguar se rrugët janë shumë të ngushta për kamionët, megjithatë është vërtetuar që kjo nuk është arsyeja.
- U propozua që problemi të zgjidhet përmes angazhimit të kompanisë përmes rekomandimeve nga Komiteti dhe autoritetet lokale, si dhe me iniciativën e banorëve për një zgjidhje të përkohshme nëse kompania nuk reagon.
- Lidhur me mbeturinat bujqësore, është theksuar nevoja për përcaktimin e një vendi të posaçëm për hedhjen e mbetjeve sezonale, për të parandaluar menaxhimin e gabuar të mbeturinave.
- Është vënë re nevoja për kontejnerë më të mëdhenj në institucionet arsimore dhe shëndetësore për përmirësimin e kushteve të menaxhimit të mbeturinave.

#### 2. Problemet e furnizimit me ujë

- Rreth 80% e lagjeve në Prelluzhë ka probleme serioze me furnizimin me ujë për shkak të tubave të vjetëruar dhe të papërdorshëm. Tubat e vjetër paraqesin rrezik për shëndetin, dhe shumë qytetarë po vënë në dyshim pagesat e faturave për ujë që nuk e marrin.
- U propozua që të ndërmerren masa urgjente për zëvendësimin e tubave dhe për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë, duke falënderuar OSBE-në për mbështetje në nisjen e këtij problemi.

#### 3. Ndihma sociale

- Komiteti mbështeti dy familje në kushte të vështira përmes dhurimit të pakove ushqimore dhe higjienike. Një nga anëtarët e komitetit, përmes miqve të tij donatorë, ka siguruar paketa ushqimi dhe higjiene për këto dy familje. Familjet që morën ndihmë ishin familjet Vasić dhe Emini.
- U identifikua një problem me tri familje romë në Prelluzhë që nuk janë lidhur me rrjetin e kanalizimit. Kompania e kanalizimit ka premtuar zgjidhjen e këtij problemi, por nuk e ka përmbushur angazhimin e saj.

#### **4. Rekomandimet dhe konkluzionet**

- Komiteti do të dërgojë rekomandime zyrtare për kompanitë që menaxhojnë mbeturinat dhe furnizimin me ujë, për të siguruar ofrimin e shërbimeve në përputhje me detyrimet e tyre kontraktuale.
- Veçanërisht do të fokusohet në zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë dhe zëvendësimin e tubave të vjetëruar.
- Do të vazhdojë mbështetja sociale për familjet në kushte të vështira, duke kërkuar ndihmë shtesë nga institucionet dhe organizatat relevante.

#### **KONKLUZION**

Komiteti për Komunitete shpreh angazhimin e tij për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në fushën e shërbimeve komunale, infrastrukturës dhe mbështetjes sociale. Të gjitha informacionet dhe rekomandimet e grumbulluara do të dërgohen te institucionet përkatëse për të siguruar një zgjidhje sa më të shpejtë.

#### **QERSHOR 2024**

##### **1. Problemet me mbledhjen e mbeturinave**

- Është identifikuar vazhdimi i problemit me mbledhjen e mbeturinave në dy rrugë në një lagje në Prelluzhë. Kompania përgjegjëse për largimin e mbeturinave nuk ka zgjidhur problemin, megjithëse qytetarët e kanë raportuar situatën. Komiteti rekomandoi hapa të mëtejshëm për të siguruar shërbimin adekuat.

##### **2. Grantet për start-up**

- Është paraqitur projekti i financuar nga Organizata për Migrim (IOM) për mbështetje të qytetarëve përmes grantëve "Start-up" deri në 4,000 euro, me një pjesëmarrje prej 10% të aplikuesit. U kërkuar që qytetarët ftohen të aplikojnë përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim ose faqes zyrtare të IOM.

##### **3. Problemet me furnizimin me ujë**

- Prelluzha përballet me probleme të rënda në furnizimin me ujë për shkak të cilësisë së dobët të ujit, presionit të ulët dhe instalimeve të vjetra. Për më tepër, qytetarëve u kërkohej borxhe të vjetra për ujë, duke shkaktuar pakënaqësi për shkak të shërbimit të papërshtatshëm.
- Është vënë re nevoja për realizimin e premtimeve të mëparshme për lidhjen në rrjetin e ujësjellësit të Vushtrrisë. Komiteti theksoi rëndësinë e përfshirjes së këtij projekti në planet për vitin e ardhshëm, nëse nuk është pjesë e planit aktual.



#### 4. Rrjeti i kanalizimit në fshatin Prelluzhë

- Rrjeti i kanalizimit në lagjen ku banon komuniteti rom në Prelluzhë nuk është përfunduar plotësisht, pasi tri familje nuk janë lidhur ende. Problemi është identifikuar si prioritet, duke theksuar se është e nevojshme të përfundojnë 50 metrat e mbetur të rrjetit.
- Komiteti apeloj ndaj autoriteteve lokale dhe kompanive përgjegjëse që të zgjidhin këtë problem dhe të ndëshkojnë ata që shkaktuan dëmtime të kanalizimit gjatë punimeve në hekurudhë.

#### 5. Rekomandime dhe konkluzione

- Është propozuar që të vazhdohet kërkesa për zgjidhjen e problemeve të mbledhjes së mbeturinave dhe furnizimit me ujë, si dhe për përfundimin e punimeve të kanalizimit.
- Qytetarët ftohen të shfrytëzojnë mundësinë e aplikimit për grantet Start-up për të përmirësuar mundësitë e tyre ekonomike.
- Komiteti do të vazhdojë të monitorojë dhe të raportojë për zgjidhjen e këtyre problemeve, si dhe problemeve tjera të qytetarëve.

#### Konkluzion

Komiteti për Komunitete apelon ndaj institucioneve përgjegjëse për të trajtuar në mënyrë efektive problemet komunale dhe infrastrukturore, duke siguruar përfshirjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve dhe planifikimin e projekteve të ardhshme.

---

### KORRIK 2024

#### Tema: Çështje të sigurisë dhe infrastrukturës në fshatin Prelluzhë

##### 1. Rritja e trafikut dhe shpejtësia e mjeteve

Në disa lagje është vërejtur një rritje e intensitetit të trafikut dhe disa shoferë po udhëtojnë me shpejtësi të madhe, duke rrezikuar sigurinë e banorëve, veçanërisht të fëmijëve. Ky problem do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Sigurisë të Komunes, me një propozim për vendosjen e ngadalësuesve të trafikut për të rritur sigurinë.

##### 2. Problemi me qen të pastrehë

Numri i qenve endacakë në fshat vazhdon të rritet dhe ka raporte për incidente, duke përfshirë lëndime të fëmijëve. Anëtarët e komitetit mendojnë se është e nevojshme angazhimi urgjent i shërbimeve përgjegjëse për trajtimin human të qenve dhe kujdesin e tyre. Propozimet për ushqimin e qenve në vendet publike janë konsideruar si një zgjidhje jo e mirë. Gjithashtu, është shprehur shqetësim për praktikën e sjelljes së qenve nga lokacione të tjera dhe lënien e tyre në fshat.

### **3. Problemet infrastrukturore**

- Dëmtimet e rrugëve dhe kanalizimit: Ndërtimi i hekurudhës ka sjellë dëmtime të rrugëve dhe kanalizimit, me rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive për shkak të rrjedhjes së fekaleve. Kërkohej një rol më aktiv i Komunës së Vushtrrisë për të zgjidhur këtë problem.
- Furnizimi me ujë dhe kanalizimi: Është theksuar përsëri se çështja e furnizimit me ujë dhe kanalizimi rregullohet përmes Komunës së Vushtrrisë dhe jo nga ujësjellësi i Prishtinës.

### **4. Siguria e fëmijëve**

Fëmijët luajnë afër rrugëve me trafik të shtuar, duke rritur rrezikun për aksidente. Është e nevojshme një plan special veror për rregullimin e trafikut.

### **5. Problemet me motorët dostues**

Është regjistruar një numër aksidentesh trafiku gjatë shpërndarjes së ushqimit nga kompanitë e motorëve. Komiteti mendon se komuna duhet të miratojë masa që do të zvogëlonin rrezikun e aksidenteve.

### **6. Marrëdhëniet etnike**

Nuk është vërejtur ndonjë problem etnik në fshat, gjë që është vlerësuar si pozitive.

### **Konkluzion**

Të gjitha këto probleme do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Sigurisë të Komunës, me propozime për masa konkrete. Qëllimi është përmirësimi i sigurisë, zgjidhja e problemeve infrastrukturore dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës për qytetarët.

---

## **SHTATOR 2024**

### **Tema: Çështjet sociale dhe komunikimi në komunitet**

#### **1. Vështirësitë në punën e Qendrës për Punë Sociale**

- Në Qendrën për Punë Sociale (CPS) ka probleme sa i përket komunikimit me komunitetet jo shumicë për shkak të mungesës së punonjësve që flasin gjuhën serbe. Është e nevojshme të angazhohet një person që mund të ofrojë mbështetje në komunikimin me të gjitha komunitetet, përfshirë ato serbe, rome dhe turke.
- Është propozuar të angazhohet një punonjës që flet disa gjuhë për të përmirësuar shërbimin për të gjitha komunitetet.

## 2. Ndërprerja e ndihmës sociale

- Familjet nga komunitete të ndryshme përballen me ndërprerjen e ndihmës sociale kur marrin fonde nga jashtë. Është ngritur çështja e bazës ligjore për këtë praktikë dhe është theksuar nevoja për mbështetje të mëtijshme për familjet, veçanërisht gjatë vitit shkollor.

## 3. Problemet infrastrukturore

- Problemi me kapacitet e pusetave në fshatin Prelluzhë ende nuk është zgjidhur plotësisht, megjithëse janë marrë disa hapa.
- Është theksuar se janë të nevojshme fonde shtesë për zgjidhjen e këtyre dhe problemeve të tjera infrastrukturore.

## Konkluzion

Problemet e përmendura, përfshirë ato sociale dhe infrastrukturore, do të shqyrtohen si prioritet në mbledhjet e ardhshme për të gjetur zgjidhje që do të kontribuojnë në kushte më të mira për të gjitha komunitetet.

## TETOR – Takimi i parë

1. **Punësimi i komunitetit rom:** Është regjistruar një nivel i lartë papunësie brenda komunitetit rom, sidomos në Prelluzhë, ku vetëm dy persona janë të punësuar në Qendrën për Mësim. Ka nevojë për punësimin e të paktën 2-3 personave nga ky komunitet. Shkalla më e lartë e arsimit ndërmjet anëtarëve të komunitetit është shkolla e mesme, përveç një individi që është student në universitet.
2. **Rinia dhe papunësia:** Papunësia e rinisë është një problem serioz, që i detyron ata të largohen nga vendi në kërkim të një jete më të mirë. Pavarësisht premtimeve parazgjedhore, nuk janë arritur zgjidhje konkrete nga autoritetet komunale.
3. **Punësimi i funksionarëve romë në komunë:** Është kërkuar që të punësohen zyrtarë nga komuniteti rom në komunë, pasi që prej disa vitesh nuk ka pasur punësim të tillë. Edhe pse disa zyrtarë komunalë kanë vetëm shkollë të mesme, komuniteti rom është i privuar nga kjo mundësi për shkak të mungesës së arsimit të lartë ndërmjet përfaqësuesve të tij. Ky raport thekson sfidat kyçe në lidhje me punësimin dhe edukimin, si dhe nevojën për mbështetje më të madhe për komunitetet jo-shumicë.

## TETOR – Takimi i dytë

1. **Përdorimi i gjuhës turke:** Është parashtruar një kërkesë për informacion nga Zyra Ligjore në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhës turke në komunën e Vushtrisë. Çështja lidhet me të drejtat e komunitetit turk, përfshirë mundësinë që gjuha turke të përdoret në dokumentet zyrtare, në mënyrë që ky komunitet të mund të marrë dokumentet e tij në gjuhën e tij. Komiteti për Komunitete ka rekomanduar unanimisht dërgimin e kësaj kërkesë në zyrën ligjore.
2. **Zyra për Komunitetet dhe Kthimin:** Është kërkuar që Zyra për Komunitete dhe Kthim të mos ftohet në takime, përveç rasteve kur ka një raport ose informatë për të paraqitur.

Komiteti ka vendosur me shumicë që Zyra për Komunitete dhe Kthim nuk do të ftohet në takime, përveç në rastet kur ka raport apo informatë për të paraqitur. Ky raport përqendrohet në çështjet kyçe që lidhen me gjuhën turke në administratën dhe komunikimin me Zyrën për Komunitetet dhe Kthimin.

## **NËNTOR**

### **Raporti i Punës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – Vushtrri (nëntor)**

Në këtë takim, anëtarët e komitetit diskutuan lidhur me raportin e punës të Zyrës për Komunitete dhe Kthimi. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthimi ka për detyrë për ti promovuar të drejtat e komuniteteve pakicë në territorin e komunës së Vushtrrisë dhe për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike. Zyra gjithashtu krijon kushte për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe për reintegrimin e të kthyerve. Zyra i ka të punësuar 9 punonjës (7 zyrtarë dhe 2 punonjës teknikë) dhe bashkëpunon me ministri të ndryshme, si dhe me organizata lokale dhe ndërkombëtare që merren me çështjet e të drejtave të komunitetit, kthimin dhe reintegrimin. Përmes takimeve të rregullta me komitetet dhe organizatat e ndryshme, zyra ofron ndihmë për komunitetet jo-shumicë për të zgjidhur problemet e tyre. Këtë vit, zyra punoi në hartimin e Planit të veprimit për reintegrimin e të kthyerve dhe integrimin e të huajve, i cili u miratua nga Kuvendi i Komunës. Po ashtu, u hartua Plani i veprimit për integrimin e Romëve dhe Ashkalive në komunë për periudhën 2024–2026. Përmes bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), zyra mbështeti dy projekte individuale, ndërsa u financuan dy kooperativa bujqësore dhe projekte për KUD "Abrašević" nga Prelluzha. Zyra gjithashtu mori pjesë në organizimin e trajnimeve për funksionarët dhe punën me të dhënat për personat e zhvendosur. Kryesuesi i zyrës u emërua anëtar i Komisionit për regjistrimin e popullsisë për vitin 2024, dhe zyra mori pjesë në takime me të gjithë udhëheqësit e zyrave komunale për komunitetet në Kosovë, si dhe në diskutime publike për planifikimin e buxhetit.

## **DHJETOR**

### **Tema: Përfundimet dhe planet e Komitetit për Komunitetet**

#### **1. Diskutimi mbi raportin vjetor për vitin 2024**

- Çështjet kyçe të komunitetit u shqyrtuan, duke përfshirë shëndetësinë, ekologjinë dhe papunësinë e të rinjve si tema prioritare për veprimtari të ardhshme.

#### **2. Çështje të tjera dhe fjalët përfundimtare**

- Për shkak të mungesës së kryetarit të komunës, diskutimi mbi problemet direkte të komunitetit u shty për takimin e ardhshëm.
- Anëtarët shprehën mirënjohjen për bashkëpunimin gjatë vitit dhe shpresën se viti i ardhshëm do të sjellë më shumë sukses në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

## Përfundimi

Pavarësisht sfidave, Komiteti identifikoi fushat prioritare për përmirësimin e punës dhe vendosi bazat për zgjidhjen më efektive të problemeve në vitin e ardhshëm.

---

## PËRFUNDIMI I RAPORTIT VJETOR TË KOMITETIT PËR KOMUNITETET PËR VITIN 2024

### Komuna e Vushtrrisë

Në vitin 2024, Komiteti për Komunitete të Komunës së Vushtrrisë mbajti me sukses 12 takime të rregullta, me theks të veçantë në zgjidhjen e problemeve të komuniteteve jo-shumicë dhe forcimin e koordinimit ndërmjet tyre. Ky vit u shënuar nga puna e angazhuar për përmirësimin e të drejtave dhe kushteve të jetesës për të gjitha komunitetet, përmes bashkëpunimit të ngushtë me autoritetet lokale, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin joqeveritar. Rezultatet kyçe të arritura përfshijnë:

- Punë intensive për zgjidhjen e problemeve mjedisore, si bllokimi i lumenjve dhe çështjet e hedhjes së mbetjeve.
- Vizita në familje në kushte socio-ekonomike të vështira dhe ofrimi i ndihmës urgjente, duke identifikuar prioritetet për mbështetje të mëtejshme.
- Veprimtari për përmirësimin e shërbimeve komunale, zgjidhjen e problemeve me furnizimin me ujë dhe rrjetin e kanalizimeve, si dhe përmirësimin e ndriçimit publik.
- Promovimi i zhvillimit ekonomik përmes mbështetjes së granteve për start-up dhe inkurajimi i të rinjve për aktivitete ndërmarrëse.
- Fokusimi në rritjen e sigurisë përmes bashkëpunimit me Këshillin Komunal për Sigurinë në Bashkësi (KKSB).

### Rekomandime për vitin 2025:

1. Të vazhdojë puna për zgjidhjen e problemeve kyçe infrastrukturore dhe komunale, me përfshirje më të madhe të komunitetit lokal.
2. Të intensifikohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare për sigurimin e burimeve të mëtejshme për projektet zhvillimore.
3. Të forcohen aktivitetet e informimit të qytetarëve për të drejtat dhe mundësitë e tyre, si grantet, subvencionet dhe thirrjet publike.
4. Të kushtohet vëmendje të veçantë çështjeve mjedisore dhe të sigurisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse.
5. Të vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë në komunë.

Në përfundim, puna e Komitetit për Komunitete në vitin 2024 është një shembull angazhimi dhe përgjegjësie ndaj qytetarëve të të gjitha komuniteteve në komunën e Vushtrisë. Rezultatet e arritura dhe sfidat e paraqitura krijojnë themelet e forta për avancimin e mëtejshëm në vitin 2025.

**Zdravko Zdravković**



Kryesues i Komitetit për Komunitete



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA "VUSHTRRI"

Nr. / Ser. 5879/25

Nr. i Eq. / Ser. nr. 2

Data / Datimi: 06.02.25



REPUBLIKA E KOSOVËS VUSHTRRI - VUCHITRAN KOMUNA E VUSHTRRIË  
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DATE /A:	06.02.2025.10.2025
REFERENCË :	05Nr. <u>201</u> /25
PËR:	KK i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave MPB, Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve
PËRMES:	z. Ferit Idrizi <u>[Signature]</u> Kryetari i Komunës së Vushtrrisë
NGA:	z. Agim Miftari <u>[Signature]</u> Sekretar dhe Kryesues i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
TEMA:	Raport i vlerësimit të dëmeve nga FNET

Në bazë të nenit 12.2, pika "d", të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 19, pika 1.4, si dhe nenet 4, pika 1,2,3 dhe neni 12, pika 1.5, bazuar në Rregullore (Qrk) Nr. 17/2015, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera ka përgatitur këtë:

## RAPORT I VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA FATKEQËIT NATYRORE DHE FATKEQËSIT E TJERA NË KOMUNËN E VUSHTRRIË - NË MUAJËT KORRIK DHE GUSHT 2024

### Dëmet në Bujqësi, korrik 2024

Më dt. 30 korrik 2024, një erë e fortë dhe breshër e ka përfshirë një pjesë të territorit të Vushtrrisë, ku ka dëmtuar një pjesë të serës me sipërfaqe prej 7.36 ari, pronë e fermerit Besim Xhaferi nga fshati Dobërlukë/K.Vushtrri.

### Dëmet në Bujqësi, gusht 2024

Më dt. 3 gusht 2024, një mot i ligë me breshër e ka përfshirë një pjesë të territorit të Vushtrrisë, ku ka dëmtuar 65 % të parcelës e mbjellur me pjepër në sipërfaqe prej 2.44 ha, pronë e fermerit Ali Xhafa nga fshati Sllatinë/K.Vushtrri.

### *Komisionet që kanë punuar në vlerësimin e dëmeve janë:*

1. Agim Miftari, Ing. i Xehetarisë-sekretar dhe kryesues i komisionit
2. Avdyl Feka, Ing. i Bujqësisë - anëtar
3. Egzon Haradinaj, Ing. i Arkitekturës - anëtar
4. Betim Grabanica, Ekonomist- anëtar
5. Fadil Selimi, Gjeodet – anëtar

*Raportit i bashkëngjisim edhe tabelat e vlerësimit të dëmeve në shtojcën I*

Tabela 1

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, korrik 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Besim Xhaferi	Dobërllukë	sera – 7.36 ari – folia - tranguj 3 ari - domate 3 ari	Era e forte dhe breshëri	1,636.85 € 1,636.85 €

Tabela 2

DËMET NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha gusht 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Ali Xhafa	Sllatinë	65% e sip. prej 2.44 ha-Pjepër	Breshëri	11,368.45 €

#### Dëmet e përgjithshme të shkaktuara nga era e fortë dhe zjarri

Nr. Ren	Përshkrimi i dëmit	Shuma e dëmit
1	Gjithsej dëme në bujqësi në muajin korrik 2024	1,636.85 €
2	Gjithsej dëme në ekonomi në muajin gusht 2024	11,368.45 €
<b>Gjithsej dëme të shkaktuara nga era dhe breshëri në territorin e komunës së Vushtrrisë në muajin korrik dhe gusht 2024</b>		<b>13,005.30 €</b>

*Dëmet në territorin e Komunës së Vushtrrisë të shkaktuara nga FNFT –era dhe breshëri në muajt korrik dhe gusht 2024, kapin vlerën 13,005.30 €*





Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa -- Kuvendin Komunal
NGA /OD/FROM	Z. Lorik Maxhuni, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
PËRMES:	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
TEMA/SUBKJEKAT/SUBJECT	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrisë
DATË/DATUM/DATE	04.02.2025

Të nderuar,

Bashkangjitur gjeni "Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrisë"

Ju faleminderit në mirëkuptim!



Komuna e Vushtrrisë



Q.K.M.F.'Dr.Safet Idrizi''Vushtrri

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E VUSHTRRISË**  
**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE**

**Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në  
Komunën e Vushtrrisë**

Shkurt 2025

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE  
’’ DR.SAFET IDRIZI ’’ VUSHTRRI  
(QKMF)-VUSHTRRI

## **I- HYRJE**

Informata për Shëndetësi e QKMF-së në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) të Komunës së Vushtrrisë, paraqet informacionin gjithëpërfshirës të organizimit dhe funksionimit të KPSH, me të cilin ofrohen të dhënat e nevojshme për shërbimet e ofruara.

DSHPS dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Ligjin për Shëndetësi, U/A për K.P.Sh, Statutin e QKMF në Vushtri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësia për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojn nivelit lokal të qeverisjes.

Raport për sëmundjet kronike (diabet, hipertension, astma) të cilat vitet e fundit po shtohen gjithnjë e më shumë si në vend ashtu edhe në komunën tonë.

Në bazë të raportit të dhënë nga infermierët e Mjekësisë Familjare kemi gjetë këto rezultate të pacientëve të vizituar në KPSH me semundje kronike:

**Tabela 28. Paraqet Raportin për sëmundjet kronike (diabet, hipertension, astma) QKMF, QMF-1, QMF-2, QMF-3 dhe 7 QMF ne fshatra**

Sëmundjet	Diabet	Hipertension	Astma
Muaji			
Janar	421	564	57
Shkurt	462	541	52
Mars	454	570	48
Prill	421	512	42
Maj	504	649	91

Qershor	483	524	82
Korrik	524	578	75
Gusht	471	514	50
Shtator	448	501	28
Tetor	440	451	50
Nentor	372	465	54
Dhjetor	380	415	52
Gjithsej	<b>5380</b>	<b>6284</b>	<b>681</b>

*Shërbimi vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehona dhe fëmijët deri ne moshën 3 vjeç*

**BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATËN JOQEVERITARE UNICEF DHE AMC**

Komuna e Vushtrrisë ka filluar me zbatimin e programit për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë prej nëntorit të vitit 2018. Vizitat e para janë realizuar në nëntor të vitit 2018 dhe vazhdojnë edhe sot.

Fillimisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe UNICEF janë trajnuar stafi shëndetësore.

Qëllimi i këtyre vizitave në shtëpi për kujdesin e nënave dhe fëmijëve është rritja e njohurive të stafit mjekësor, grave shtatzëna dhe nënave të reja në kujdesin antenatal, kujdesit pas lindjes, depresionit pas lindjes, zhvillimi i fëmijës në moshë të hershme (0-3 vjeç), roli i partnerëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes për të ofruar mbështetje si dhe për të ofruar qasje për të gjithë dhe për të mbrojtur e përmirësuar gjendjen shëndetësore të nënës dhe fëmijës në mënyrë që të bëhet plotësimi i nevojave të çdo individit, veçanërisht të grave, fëmijëve, duke ofruar shërbime cilësore.

Vizitat në shtëpi ndihmojnë familjet në identifikimin e problemeve të posalindurit, duke përfshirë shenja të sëmundjeve dhe në të njëjtën kohë përkrahen praktikat si të ushqyerit me qumësht të gjirit, vaksinim me kohë dhe të plotë, ne gjithashtu me këto vizita kontribuojmë që fëmija të rritet dhe të zhvillohet më mirë në arritjen e potencialit të plotë të fëmijës.

**Tabela nr. 29 paraqet Numrin e përgjithsëm i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë**

Raporti i Vizitave Shtëpiake deri ne moshen 3 vjeqare 2024													
VSH	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Numri i vizitave për	235	273	130	100	108	108	140	121	94	125	120	50	<b>1604</b>
per femijet 0-3 vje	51	51	15	50	36	32	30	27	41	45	48	20	<b>446</b>
	5	3	1	0	0	0	1	0	2	0	2	0	<b>14</b>
Numri total	286	324	145	150	144	140	170	148	135	170	168	70	<b>2050</b>

Gjatë vizitit 2024 janë trajnuar 5 doktor për aplikimin e instrumentit ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijës “GMCD” dhe 22 infermier.

**Të arriturat**

- Rritja e numrit të vizitave të relalizuara në shtëpi
- Zvogëlimi i numrit të vizitave virtuale
- Aplikimi i instrumentit ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijës “GMCD”
- Në bashkëpunim me zyrën e financave në QKMF për vizitat shtëpiake janë siguruar dy numra dhe mbushje mujore
- Në bashkëpunim me zyrën e financave në QKMF janë blerë dy pompa për gjdhënie, një elektrike dhe një manuale
- Identifikimi i fëmijëve me ngecje në zhvillimi si dhe referimi i tyre
- Bashkëpunimi me QKUK për të siguruar të dhënat për lindjet nga komuna e Vushtrrisë
- Bashkëpunimi me familjet gjatë vizitave shtëpiake
- Rritja e satifaksionit me shërbimin e vizitave shtëpiake

#### **Sfidat**

- Gjatë vitit 2024 ka qene nje numer i vogel i familjeve qe kane refuzuar vizitën me pretekstin se kanë mjekun e tyre pediatër dhe nuk kanë nevojë për vizita të tilla.
- Numri i vogël i stafit të angazhuar për të realizuar vizita shtëpiake

#### **Planet per te ardhmen**

- Rritja e numrit te vizitave në shtëpi
- Rritja e numrit të infermierëve që realizojnë vizita shtëpiake
- Aplikimi i GMCD gjatë vizitave shtëpiake
- Rritja e cilësisë së vizitave shtëpiake.

*Në kuadër të dhomës së vizitave shtëpiake që gjendet në QKMF në katin e 3 organizohen edhe tre shërbime të tjera:*

1. *Kujdesi ne grup për shtatzënat*
2. *Klasa për nëna*
3. *Kujdesi ne grup për prindërim*

#### **Shërbimi “KUJDESI NË GRUP PËR GRATË SHTATZËNA”**

Kujdesi në grup me gratë shtatzëna mbledh shtatzënat nga java 10-12 e shtatzanisë dhe njëherë në muaj për dy orë organizohen sesione informuese nga dy infermiere të cilat janë të trajnuara paraprakisht. Numri i grave të lejuara në një sesion është jo më pak se 3 gra të cilat duhet të kenë të përafërta javët e shtatzanisë. Krijimi i grupeve nuk duhet së ndaluri asnjëherë, një grup fillohet dhe në rastin kur formohet grupi tjetër me shtatzëna tjera grupi duhet të filloj menjëherë në bashkëpunim me shtatzënat se kur ju përshtat data dhe ora e takimit.

Secili sesion i organizuar i ka temat e ndryshme duke u lidhur me periudhën e shtatzanisë dhe zakonisht temat janë të organizuara nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Në një sesion me lejen e shtatzënave mund të marrin pjesë edhe baballarët ose edhe ndonjë mbështetës tjetër, ndërsa në bazë të temave mund të ftohen edhe profesionistë të tjerë shëndetësor të cilët mund të kontribuojnë në mirëqenien e gruas shtatzënë. Në fund pas lindjes së seciles grua pjesëmarrëse në sesion, organizohet një sesion i pas lindjes, nënat vijnë në sesion bashkë me bebat.

Deri më tani në Vushtri është shfrytëzuar repartin i Gjinekologjisë në Spitalin “Sheikh Zayed” konkretisht ambullanta gjinekologjike, për secilin grup të formuar dy infermiere cdo ditë kanë vizituar ambullaten e gjinekologjise për tu takuar me shtatzënat dhe për ti bindur ato që të jenë pjesëmarrëse në sesionet e organizuara.

Nga viti 2023 fillon punën shërbimi kujdesi ne grup me gratë shtatzëna, deri më tani janë organizuar gjithsej 4 grupe me gratë shtatzëna.

Një grup është fasilituar nga Adlije Shaqiri Kurti së bashku me Fatmire Krasniqin, ndërsa 3 grupë të tjera janë fasilituar nga Anjezë Haradinaj Tahiri së bashkë me Gyltene Hazirin, ndërsa të 4 grupet janë formuara me angazhimin e Anjezës dhe Gyltenes.

### Shërbimi “KLASA PËR NËNA”

Në vitin 2023 një staf prej 4 infermierëve është trajnuar për të organizuar takime informuese për gratë shtatzëna, për lehonat, për gratë që planifikojnë shtatzani dhe për baballarët.

Përkundër trajnimeve dhe pajisjes së dhomës më inventarin e nevojshëm nga AMC, vetëm nga prilli i vitit 2024 komuna e Vushtrisë ka filluar për herën e parë të raportoj punën e organizuar në këtë shërbim.

Takimet në klasa ndihmojnë dhe mbështesin një shtatzani të shëndetshme, për përkrahje të ushqyerjes në 6 muajt e parë ekskluzivisht me gji, ushtrmet e lejshme gjatë shtatzanisë etj.

**Tabela nr.30 Takimet e organizuara në klasa**

Komuna e Vushtrise	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1 Shqiptare					15	16	21	18	13	10	16	8	117
2 Rom					0	0	0	0	0	0	0	0	0
3 Ashkali					0	0	0	0	0	0	0	0	0
4 Egjiptian					0	0	0	0	0	0	0	0	0
5 Te tjere					0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Numri total i perfituesve</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>21</b>	<b>18</b>	<b>13</b>	<b>10</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>117</b>
6 Numri i vajzave/grave					1	2	4	2	3	2	3	1	18
8 Numri i gifteve					0	3	2	2	4	2	2	2	17
9 Numri i grave shtatzena					10	6	4	10	10	2	6	2	50
10 Numri i lehonave					4	2	10	4	5	2	4	2	33
11 Dy vizita gjatë shtatzënisë në klasa					0	1	2	3	2	1	3	1	13
12 Moshë (<18)					0	0	0	1	0	0	0	0	1
13 Moshë prej 18 deri 30					13	10	15	12	13	6	6	8	83
14 Moshë prej 31 deri 40					2	4	3	5	3	2	6	0	25
15 Moshë mbi 41					0	2	3	0	2	0	4	0	11
16 Fshat					9	10	13	8	11	6	10	7	74
17 Qytet					6	6	8	10	7	4	6	1	48
18 Lindje natyrale					6	4	6	2	5	1	3	0	27
19 Lindje me operacion (S.C)					5	3	4	2	4	1	2	2	23
20 Numri i prenatalave të shperndare					0	10	15	6	7	8	10	8	64
21 Numri i broshurave të shperndara					0	2	5	7	3	1	3	2	23
22 Referime					0	0	0	0	0	0	0	0	0
23 Perfshirja e baballarëve					0	3	2	1	2	1	3	1	13
24 Grupi i gjakur 0 negativ					1	3	1	2	1	1	2	0	11
25 Periudha e Raportimit													
26 Raportuesi					Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	0
					Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	0

Pra në kuadër të shërbimit klasa për nëna numri i përfituesve është gjithsej 117, dhe janë dhuruar 64 pako me prenatale (me vitamina për shtatzënë) të cilat pako janë siguruar në bashkëpunim me AMC-në.

### SHËRBIMI “KUJDESI NË GRUP PËR PRINDËRIM”

Në vitin 2024 janë trajnuar gjithsej 16 infermiere prej QKMF-Vushtrri nga AMC, UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Deri më tani janë krijuar 2 grupe dhe fasilituese të këtyre grupeve janë 3 infermiere, pra janë krijuar 2 grupe në kombinim me 3 infermiere.

Në këtë shërbim organizohen sesione për prindërit bashkë me fëmijët e tyre prej muajit të parë të lindjes deri në muajin e 17, pra gjithsej organizohen 7 sesione.

Sesioni i parë përfshinë periudhën prej 1-2 muaj, sesioni i dytë 3-4 muaj, sesioni i tretë 5-6 muaj, sesioni i katërt 7-8 muaj, sesioni i pestë 9-11 muaj, sesioni i gjashtë 12-14 muaj dhe sesioni i shtatë përfshinë periudhën 15-17 muaj të fëmijës.

*Në kuadër të këtyre shërbimeve që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës, në komunën e Vushtrrisë është organizuar java e gjdhënies, nëpërmjet vizitave në shtëpi, sesioneve me gratë shtatzëna dhe takimet e organizuara në klasën për nëna me nëna dhe baballarë.*

Java e gjdhënies në Vushtri

01-08-2024-07.08.2024

Hyrje & Objektivat

Java Botërore e ushqyerjes me gji mbahet çdo vit në javën e parë të gushtit në mbarë botën, në Kosovë kjo fushatë është mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, Unicef dhe Action for Mother and Health dhe partnerë të shoqërisë civile. Moto për këtë vit është: Të mbështesim gjdhëninën Përmes programit “vizitat në shtëpi për nënat dhe fëmijët 0-3 vjeç” “Kujdesi në Grup” dhe “Klasa për Nëna” qendra kryesore e mjekësisë familjare në Vushtri “Dr. Safet Idrizi” ka organizuar disa aktivitete për këshillim dhe edukim të veçantë për nënat lidhur me gjdhëninën.

**Objektivat e aktiviteteve të organizuara:**

- Këshillimi i nënave/shtatzënave për gjdhëninën
- Edukimi i nënave/shtatzënave për gjdhëninën
- Mbështetja e nënave për gjdhëninën

**Tabela nr.31 aktivitetet e organizuara**

Nr.	Programet	Aktivitetet	Vendodhja	Rezultatet
1	Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	Vizitë në shtëpi	Në shtëpi tek familjet	<p><b>Këshillimi i nënës për gjdhëninën</b></p> <p><b>Praktimi i gjdhënies nga lehona</b></p> <p>Këshillimi i nënës për kujdesin ndaj foshnjës</p> <p>Këshillimi i nënës për vaksinimin e fëmijës</p> <p>Këshillimi i nënës për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.</p>
2	Kujdesi në grup	Organizimi i sesionit shtesë informues për gjdhëninën për grupin e 4	Në objektin e QKMF, kati 3, nr. 16	<p>Praktimi i gjdhënies nga secila shtatzënë</p> <p>Diskutimi për mënyrat e gjdhënies</p> <p>Ndërgjegjësimi i grave për të mirat e gjdhënies për nënën dhe fëmijën</p>

Ndërgjegjësimi i grave për rëndësin e ushqerjes ekskluzive me gji në 6 muajt e parë dhe ushqyerja deri në 2 vite e gjysmë me gji dhe ushqime shtesë.

3	Klasa për nëna	Takimi me lehonat pas vaksinimit të fëmijëve me BCG	Në objektin e QKMF, kati 3, nr. 16	Praktimi i gjdhënies nga nënat Mbështetja e baballarëve për gjdhënien Diskutimi për mënyrat e gjdhënies Diskutimi për rëndësin e gjdhëniës si për nënë ashtu edhe për fëmijën.
Promovimi i gjdhënies në qytet	Shpërndarja e fletushkave	Sheshi “Adem Jashari”	Shpërndarja e fletushkave për vetëdijësimin e shtatzënave/lehonave dhe nënave për rëndësin e gjdhënies Diskutimi për benefitet e gjdhënies si për nënën ashtu edhe për fëmijën	

#### • **VIZITAT SHTËPIAKE PALIATIVE**

*Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.*

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRË Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Ëorldëide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2024:

**Raport janar – dhjetor 2024 mujor i punës për projektin ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri**

- **Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :**
  - Gratë shtatzëna dhe lehonat;
  - Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
  - Personat me aftësi të ndryshme;
  - Personat me sëmundje kronike;



- Pesonat me sëmundje malinje;

- **Për ofrimin e shërbimeve mjekësore janë furnizuar sipas kërkesës:**

1. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
2. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;
3. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile;

- **Organizimi i punës:**

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë për dhënien dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2023 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani dy ekipe mjekësore ( 2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënien e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas nevojës, EKG, dhënien e terapisë paranterale ( intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.

Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

- Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

Pozita profesionale	Numri i nëpunësve
Doktor të Mjekësisë	7
Infermier të Përgjithshëm	14
Teknik laborant	2
Asistent stomatologu	1

*Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.*

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRË Kosova, angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Ëorldeide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2024:

**Tabela nr.32 paraqet Raportin janar – dhjetor 2024, i punës për projektin ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri**

Nr.	Raport 12 mujor 2024	Numri total i vizitave	Vizita shtëpiake	Meshkuj	Femra	Numri I vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç	Numri i vizitave lehonave	Numri I vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç	Shërbime në vizita shtëpiake	Totali i Shërbimeve
1	Janar	2628	1304	565	739	1365	30	44	2110	11145
2	Shkurt	1495	1098	651	844	751	66	155	2637	3840
3	Mars	1562	1433	553	880	776	75	130	2249	3019

	<b>Totali, TM1</b>	<b>5685</b>	<b>3835</b>	<b>1769</b>	<b>2463</b>	<b>2892</b>	<b>171</b>	<b>329</b>	<b>6996</b>	<b>18004</b>
4	Prill	1376	1270	559	817	747	50	100	2082	2771
5	Maj	1691	1413	708	983	850	19	109	2168	3745
6	Qershor	1533	1309	644	889	814	32	92	2014	3195
	<b>Totali, TM2</b>	<b>4600</b>	<b>3992</b>	<b>1911</b>	<b>2689</b>	<b>2411</b>	<b>101</b>	<b>301</b>	<b>6264</b>	<b>9711</b>
7	Korrik	1662	1503	691	812	869	140	30	2184	3197
8	Gusht	1584	1382	595	787	846	31	121	2320	3664
9	Shtator	1600	1398	582	816	748	41	94	2225	3619
	<b>Totali, TM3</b>	<b>4846</b>	<b>4283</b>	<b>1868</b>	<b>2415</b>	<b>2463</b>	<b>212</b>	<b>245</b>	<b>6729</b>	<b>10480</b>
10	Tetor	1532	1422	675	747	790	45	125	2443	3344
11	Nentor	1452	1318	640	678	746	47	119	2223	3095
12	Dhjetor	1886	1278	644	634	938	20	52	2367	4173
	<b>Totali, TM4</b>	<b>4870</b>	<b>4018</b>	<b>1959</b>	<b>2059</b>	<b>2474</b>	<b>112</b>	<b>296</b>	<b>7033</b>	<b>10612</b>
	<b>Totali vjetor</b>	<b>20001</b>	<b>16128</b>	<b>7507</b>	<b>9626</b>	<b>10240</b>	<b>596</b>	<b>1171</b>	<b>27022</b>	<b>48807</b>

#### • SATISFAKSIONI I PACIENTËVE

Statisfaksioni i pacientëve është një formë e rëndësishme e vlerësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Anketat e satisfaksionit të pacientëve mund të ndihmojnë të identifikojmë mënyrat për të përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor. Është mjaft e rëndësishme për të parë saktësisht se çfarë opinioni kanë lidhur me shërbimet shëndetësore. Në fund të fundit kjo nënkupton se kujdesi është më i mirë dhe pacientët janë më të kënaqur. Pacientët e kënaqur me shërbime kanë më tepër gjasa t'u përmbahen trajtimit të rekomanduar, të vijnë-kërkojnë vizita përcjellëse dhe të mbesin vetëm me një mjek dhe jo ti ndërrojnë mjekët. Për më tepër, matja e kënaqëshmërisë së pacientit, i tregon stafit tonë dhe komunitetit që ne jemi të interesuar për cilësi. Kjo tregon se ne jemi në kërkim të mënyrave për të përmirësuar dhe duke bërë gjërat më mirë. Nga këto anketa mund ti shohim saktësisht se çfarë thonë pacientët për kujdesin shëndetësor që ofrohen nga ekipet tona. Kjo na bënë me dije se nëse kujdesi është më i mirë pacientët janë më të lumtur.

#### **QËLLIMI**

Qëllimi i hulumtimit është identifikimi i nevojave për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes duke matur opinionet e pacientëve në aspekte të ndryshme lidhur me cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga ekipet e terrenit për pacientët e komunës së Vushtrrisë.

#### **OBJEKTIVA**

Objektivë e hulumtimit është marrja e opinionëve të pacientëve lidhur me aspektet e ndryshme të cilësisë së shërbimeve shëndetësore që ofrohen në vizitat shtëpiake për:

- Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
- Personat me aftësi të ndryshme;
- Personat me sëmundje kronike;
- Personat me sëmundje malinje;

## ***METODOTOLOGJIA E HULMTIMIT***

Pas marrjes së pëlqimit dhe përkrahjes, si dhe subjekteve pjesëmarrëse në këtë hulumtim, janë shpërndarë pyetësorët e strukturuar si dhe janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme për mënyrën e plotësimit të tyre.

Pyetësori përmban 21 pyetje. Në anketim janë përfshirë 36 pacient, 18 nga qyteti dhe 18 nga fshatrat. Pyetësori ka qenë anonim dhe me të shkruar për arsye që të ketë kosto efektivitet dhe besueshmëri.

## ***KONKLuzionET***

Gjatë realizimit të kësaj informate kemi konstatuar se për shërbime të ndryshme që ofrohen në vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes në komunën e Vushtrisë, pacientët e anketuar kanë dhënë vlerësime të ndryshme. Nga analizimi i të dhënave të grumbulluara konstatojmë se përqindja më e madhe e pacientëve/klientëve janë shumë të kënaqur me shërbimet që ofrohen.

Pas analizimit të pyetësorëve si përmbledhje do të themi se pjesa më e madhe e pacientëve/klientëve janë të kënaqur me shërbimet që i'u ofrohen.

Janë anketuar mbi opinionet 36 anketues, ku vlen të theksohet se kënaqshmëria për shërbimet është e nivelit shumë të kënaqur 99%, kurse të kënaqur 1%. Sa i përket opinionëve shumë të pa kënaqur, i pa kënaqur dhe nuk dua të përgjigjem kemi pasur 0 % nga anketuesit.

Vlerësimi i përgjithshëm, mjekësor, furnizues në qytet dhe fshat vlejnjë të theksohet se kënaqshmëria arrin maksimumin përveç tek pyetja se sa jeni te kënaqur me furnizimit me terapi e cila ka një përqindje më të ulët andaj nga 36 të anketuar 3 prej tyre janë të pa kënaqur.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova • Republic of Kosova



Komuna Vushtrri  
Opstina Vucitrn • Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	04.02.23025
REFERENC-Ë:	08Nr.52
PËR/ZA/TO:	Kryesuesën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë Znj. Melihate Basholli-Latifi, Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtori i drejtorisë Drilon Jusufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për Leje Ndertimore për Vitin 2024

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me procedurën e kërkesave për Leje Ndertimore për vitin 2024 , DUMM ju informon se gjatë vitit 2024 ka pranuar 95 kërkesa për Leje Ndertimore duke përfshi kategorin e I-rë dhe të II-të të ndërtimit.

DUMM pas pranimit të kërkesave të parashtruara nga palët , ka shqyrtuar këto kërkesa dhe ju njofton se ky organ gjatë shqyrtimit të kërkesave për Kushte Ndertimore për kategorinë e I-rë dhe II-të , gjatë lëshimit të Lejeve Ndertimore për kategorinë e I-rë dhe II-të, si dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të vepron komfor dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërtim 04/L-110, Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor të Kosovës Nr.04/L-174 të datës 31.07.2013, Udhëzimit Administrativ 06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndertimore, Leje Ndertimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të, Udhëzimit Administrativ 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve, Udhëzimit Administrativ 08/2017 të datës 09.06.2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Rregulloren e MMPH-së Nr.03/2016 të datës 04.11.2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi, Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurën për Ndërtimin e Objekteve në Territorin e Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.205/13 të datës 10.09.2013 (aty ku nuk bie ndesh me ligjin dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga MMPHI) , Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 të Komunës së Vushtrrisë si dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor.

Komuna e Vushtrrisë ka vetëm Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Pra, DUMM-ja për të gjitha kërkesat të cilat kanë të bëjnë me pajisjen me Kushte dhe Leje Ndërtimore respekton hierarkinë:

1. Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor të Kosovës Nr.04/L-174 të datës 31.07.2013;
2. Ligji për Ndërtim 04/L-110;
3. Udhëzimi Administrativ 06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të;
4. Udhëzimi Administrativ 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve;
5. Udhëzimi Administrativ 08/2017 të datës 09.06.2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;
6. Rregulloren e MMPH-së Nr.03/2016 të datës 26.03.2014 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimet në Bashkëpronësi,
7. Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 të Komunës së Vushtrrisë si dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor
8. Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurën për Ndërtimin e Objekteve në Territorin e Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.205/13 të datës 10.09.2013.

-Janë lëshuar 38 Kushte Ndërtimore për kategorinë e I-rë dhe të II-të

-Janë lëshuar 13 Leje të kategorisë së II-të si dhe janë lëshuar 17 leje ndërtimore të kategorisë së I-rë, po ashtu janë refuzuar 12 kërkesa për caktimin e Kushteve Ndërtimore si dhe Lejeve ndërtimore, ndërsa 15 janë mbetë në procedurë për vitin 2025

Vlenë të theksohet se Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësiive përkatësisht në sektorin e Urbanizimit.

DUMM gjatë punës në këtë vit ka qenë e ngarkuar me mjaftë punë të cilat besojmë që i kemi kryer me sukses, edhe për kunder numrit shumë të vogël të stafit që ka pas kjo drejtori.

Me respekt,

REPUBLICA  
KOMUNA

104/25

Nr. i fto

Date: 06.02.2025

REPUBLICA - VUCITEN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Informatë  
lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi  
për vitin 2024

Shkurt 2025

Këshilli komunal për siguri në bashkësi i themeluar me Udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill ka për qëllim rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë së tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Në vitin 2024 janë mbajtur gjithsej 5 mbledhje, sipas Udhëzimit Administrativ. Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit kanë diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara, gjithashtu kemi pasur pothuajse çdoherë prezent organizatat ndërkombëtare KFOR-in, OSBE-në, UNMIK etj.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar problemet e ndryshme që i preokupojnë qytetarët e Vushtrrisë dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe evitimin e tyre.

Vlen të theksohet se në aspektin e sigurisë - janë shtuar masat e sigurisë në trafik në periudha të caktuara kohore gjatë kohës kurë fëmijët shkonin në shkolle ku duhet ta kalojnë rrugën dhe gjatë sezonit veror kurë ka ekzistuar fluksi i madh i bashkatdhetarëve

Gjithashtu ka bere kontrollimin e armëmbajtjeve, ku si rezultat i këtij kontrolli janë konfiskuar një numër i armëve. Policia është angazhuar në parandalimin e gjuajtjeve me armë zjarri në ahengje të ndryshme, por fatmirësisht numri i tyre është në zvogëlim e sipër, pasi që njerëzit po vetëdijesohen.

Sipas raporteve të policisë numri më i madh i veprave penale është kundër pasurisë, pra vjedhjet dhe vjedhjet e rënda por me angazhimin e shtuar të Policisë, ky numër është dukshëm më i vogël se vitin e kaluar, por në këtë vit është rritur numri i veprave penale të narkotikëve.

Anëtarët e KKSB-së nga radhët e komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali, kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar problemet dhe kërkesat e tyre para anëtarëve të këshillit, me të cilat është njoftuar këshilli, me ç'rast janë nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve.

Komandanti i Stacionit Policor, përveç raportimit të rregullt për gjendjen e sigurisë, njëkohësisht ka raportuar për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, me përfaqësues të komuniteteve gjatë punës në terren, ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi etnike.

Përveç KKSBB-së, edhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi si KLSP që përfshin fshatrat: Gojbulë dhe fshatrat Karaçë, Begaj, Sllatinë, Banjskë, Tërllabuq dhe Bashkësia lokale "Kalaja" në Vushtrri si dhe KLSP – Prelluzhë, ku përfshihen fshatrat (Gllavatin, Bivolak, Beçuk, Stroc, Zhilivodë, kanë funksionuar në mënyrë të rregullt. Kurse në qershor të vitit të kaluar është formuar edhe KLSP që përfshin qytetin e Vushtrrisë.

Këto këshilla lokale, kanë mbajtur takime në të cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi dhe interes për komunitetin, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës






REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi



**Plani i Punës  
i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025**

SHKURT 2025

## Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS) është organ këshillues, në bashkëpunim me Policinë analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë. Objektiv i KKSBS-së është ngritja e vetëdijes kundër llojeve të ndryshme të krimit, kundër prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike përkatësisht krijimin e ambientit për implementimin e një koncepti të sigurisë në bashkësi ku jetojmë, duke mundësuar që institucionet e sigurisë të hyjnë në partneritet me qytetarët e komunës në mënyrë që të evidentohen rastet dhe të ndërmerren masa preventive në parandalimin e tyre.

Në zbatimin e Planit vjetor të KKSBS-së, padyshim rol më të rëndësishëm kanë: Kryetari i Komunës, që njëherit është edhe kryesues i KKSBS-së Policia, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Inspektime, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Arsim, ZBGJ, FSK-ja etj. Krahas mekanizmave institucional komunal në zbatimin e Planit, komuna bashkëpunon edhe me institucionet vendore siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria për Kthim dhe Riatdhesim etj. si dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Qëllimi i Planit të veprimit për siguri në bashkësi është koordinimi efikas i punës dhe aktiviteteve të institucioneve bashkë me qytetarët për të ndërtuar një shoqëri e cila jeton në paqe dhe pa kërcënime nga rreziqet që prekin sigurinë publike personale dhe të pronës duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Komunës së Vushtrrisë, si një vendë i qetë, multi etnik dhe me standarde të larta të sigurisë

Mbledhjet e KKSBS-së janë të rregullta, minimumi 6 mbledhje në vit, tre në tremujorin e parë dhe tre në tremujorin e dytë.

Kryesuesi i KKSBS-së dhe Sekretaria në vazhdimësi i respektojnë afatet kohore për caktimin e mbledhjeve të KKSBS-së, dërgimin e ftesave për mbledhje, përpilimin e procesverbalit, Planit të punës, Raportit të punës, si dhe dhënien e informatave të dy Ministrive të lartë cekura dhe organizatave ndërkombëtare lidhur me punën e KKSBS-së

Aktivitetet e KKSB-së

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Bartësit e Aktiviteteve	Realizimi i aktivitetit	Vërejtje
1	Promovimi i vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera.	Promovimi i bashkëjetesës si mënyrë e jetesës në paqe ( ligjerata në shkolla) në shkolla dhe institucione fetare	Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Bashkësitë fetare	Gjatë gjithë vitit	
2	Aktivitetet ne identifikimin dhe pengimin e rreziqeve kundër radikalizmit dhe ekstremizmit si dhe rehabilitimin e atyre që kanë qenë të involvuar në luftërat e huaja.	Organizimi ligjëratave me maturantet e shkollave të mesme të larta, si dhe në bashkësitë fetare lidhur me rreziqet e ekstremizmit dhe radikalizmit.	Institucionet komunale Policia e Kosovës Bashkësitë fetare	Maj me maturant Shtator, dhjetor, prill në bashkësitë fetare	
3	Parandalimin i aksidenteve në rrugë.	Fushatë vetdijësuese për ngasësit e automjeteve	Policia e Kosovës, Komuna	Nëntor & Prill	
4	Parandalimi i vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda	Aktivitete parandaluese	Policia e Kosovës	Gjatë gjithë vitit	
5	Parandalimi i përdorimit të drogës nga të rinjtë sidomos ne shkolla.	Fushatë vetdijësuese me nxënës të shkollave të mesme të larta	Policia e Kosovës, Drejtoria e Arsimit, Këshilli i Prindërve Inspekcioni,	Shtator, nëntor, shkurt, prill	

		Takime informuese me prindër	Këshilli i arsimtarëve dhe Këshilli i nxënësve të shkollës		
6	Angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijante dhe dhunës në shkollat e komunës sidomos ato të arsimit të mesëm	Kontrolle të rregullta për armëmbajtje të nxënësve në shkolla Trajtimi i dhunës në shkolla në takimet prindër-arsimtar	Institucionet arsimore, ZMF(Zyrtari për Mbrojtjen e Femijeve) Policia e Kosovës, Prindërit	Gjatë gjithë vitit shkollor	
7	Pengimi dhe parandalimi i dhunës në familje .	Fushatë vetëdijësuese  Veprime parandaluese	Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, ZBGJ dhe Bashkësitë fetare	Gjatë gjithë vitit	
8	Parandalimi i konflikteve dhe vrasjeve në shoqëri	Identifikimi me kohë i situatave të tensionuara në shoqëri Veprimet parandaluese	Policia e Kosovës QPS Institucionet, shoqëria civile dhe Bashkësitë fetare.	Gjatë gjithë vitit	
9	Pengimin e qytetarëve që prishin rendin publik.	Identifikimi i rasteve Zbatimi i masave	Policia e Kosovës Inspekcioni Policia	Gjatë gjithë vitit	
10	Aktivitetet për pengimin e zjarreve fushore si dhe marrja e masave parandaluese	Fushata vetëdijësuese për dëmet e zjarreve të qëllimshme Identifikime i rasteve	Policia e Kosovës Komuna – Njësi i Zjarrfikësve dhe Këshillat e fshatrave.	Sidomos gjatë stinës së verës	
11	Aktivitetet e shitjes së pa autorizuar të mjeteve shpërthyes .	Shtimii kontrollit nga inspektoriati dhe Policia	Policia E Kosovës Inspekcionin	Muaj dhjetor	

		Identifikimi i shitësve Zbatimi i masave ligjore			
12	Aktivitetet e mbrojtjes në punë.	Inspektimet rregullta e	Inspektorati i Punës	Gjatë gjithë vitit	
13	Masat mbrojtëse gjatë ndërtimit të objekteve të larta.	Inspektimet rregullta e	Inspektorati i punës	Gjatë gjithë vitit	
14	Pengimi i shfrytëzimit të rërës në shtretërit e lumenjve dhe dëmtimi i argjinaturave	Kontrollet rregullta të lumenjëve nga inspektorati dhe policia e	Inspektorati komunal dhe policia	Gjatë gjithë vitit	
15	Rregullimin e kanaleve kulluese nëpër tokat bujqësore të cilat janë të rrezikuara nga vërshimet	Identifikimi i pengesave  Sanimi i dëmtimeve dhe pastrimi i kanaleve	NH "Ibër Lepenc" komuna	Gjatë kohës kur nuk ka apo ka më pak te lashta, në tokat bujqësore	
16	Masat në pengimin e ndotjes akustike.	Paisja e inspektorave me aparate për matjen e ndotjes akustike Identifikimi i vendeve që shkaktojnë ndotje akustike Zbatimi i masave ligjore	Inspektorati komunal dhe Policia e Kosovës	Gjatë gjithë vitit	
17	Masat për eliminimin e rrezikut nga qentë endacak.	Hartimi i projektit për menaxhimin e qeneve endacak	komuna	Gjatë gjithë vitit e sidomos gjatë sezonit të dimrit.	

		Zbatimi i projektit			
18	Identifikimi i rreziqeve që sjellin rrjetet e elektrike dhe trafot.	Kontrollet e rregullta Njoftimi i KEDS-it	Komuna KEDS-i	Gjatë gjithë vitit, sidomos gjatë përkeqësimit të motit – erërave të forta apo reshjeve të mëdha të bores.	
19	Mbikëqyrje e lokaleve hoteliere që mos të shërbehen me pije alkoolike fëmijët nën moshën 18 vjeçare.	Kontrollet e lokaleve hoteliere që shërbejnë pije alkoolike	Policia e Kosovës Drejtoria e Inspektimit	Gjatë gjithë vitit	
20	Mbikëqyrje e lokaleve-kafiterive e veçanërisht ato që ekzistojnë afër objekteve shkollore ku mundësitë për trafikim me mjete narkotike janë më të mëdha.	Vizitat e lokaleve Përcjellja e produkteve që i shesin këto lokale Paralajmërimi i shitësve të këtyra lokaleve për rreziqet dhe penalizimi	Policia e Kosovës Inspektorati komunal	Gjatë gjithë vitit	
21	Këshillat e nxënësve të veprojnë të organizuar nëpër shkolla, në aspektin e sigurisë në trafik.	Drejtoria e Arsimit Drejtorët e shkollave	Policia e trafikut dhe NJKDNJ	2 herë brenda vitit	
22	Aktivitetet e parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore	Fushata vetdijësuese me gjeneratat e reja	Policia e Kosovës kryetarët e fshatrave dhe bashkësive të lagjeve, ZBGJ dhe ZMF	Dy here në vit	
23	Pengimin i krijimit të deponive ilegale	Pastrimi i deponive ekzistuese Ndalimi i krijimit të deponive përmes kontrollit	Inspekcioni komunal Policia e Kosovës	Në vazhdimësi	

24	Kontrollimi i kombibusëve për mos tejkalimin e numrit të nxënësve sa i përket nr. të ulëseve	Kontrollet e rregullta gjatë orarit të transportit Penalizimi i shkelësve të ligjit	Policia e Kosovës Inspektori i komunikacionit	Sipas nevojës	
25	Përcjellja e rasteve të inkurajimit dhe shkuarjes së individëve nga Komuna e Vushtrrisë në luftërat e huaja dhe ndërmarrja e masave ligjore	Fushatë vetdijësuese	Policia e Kosovës Organet e Drejtësisë	Në vazhdimësi	





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr. / Br 100/25

Kr. / fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data / Datum 05.02.2025

VUSHTRRI - VUČITRAN



## REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PËR:	Sekretarise se Kuvendit Komunal
PËR NJOFTIM:	z.Rrahim Ajeti, Fshati Stanoc i Poshtëm Komuna Vushtrri
PËRMES:	
NGA:	z.Ferit Idrizi Kryetar i Komunes
TEMA:	Kërkesa, ju dërgohet për shqyrtim

Të bashkangjitur keni kërkesën Nr.02-104/02-3632/25 të dt.23.01.2025 të z.Rrahim Ajeti, Kryetar i Këshillit të Fshatit Stanoc i Poshtëm, Komuna Vushtrri, për ndihmë financiare për rregullimin e kulmit të shtëpisë së komunitetit në këtë fshat.

Kërkesa në fjalë i dërgohet Komitetit per Politikë e financa e tani të procedohet për Kuvend për shqyrtim të mëtejshëm.





Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia

Data 23/01/2025

Kryetari i Komunës

Mos shkruani në këtë pjesë

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Numri personal

Rrahim Ajeti

1004612732

Adresa e vendbanimit

E-mail Adresa

Stanoc i Poshtëm

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44503000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Numri i protokolit

02-104/02-0003632/25

Afati i zgjedhjes

22/02/2025

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per ndihme financiare

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Rrahim Ajeti vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

  
(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: florjana.krasniqi

**Data: 23.01.2025**

**Për: Ferit Idrizi - Kryetar i Komunës Vushtrri**

**Nga: Rrahim Ajeti - Kryetar i Këshillit të Fshatit Stanoc i Poshtëm**

**Lënda: Kërkesë**

---

I nderuar,

Pas takimit që patëm me ju, e pamë të arsyeshme që t'ju drejtohem me këtë kërkesë për të na dalur në ndihmë me mjete financiare në shumën prej 3.000 euro për rregullimin e kulmit të shtëpisë së komunitetit në fshatin tonë – Stanoc i Poshtëm.

Me shpresë se kjo kërkesë do të hasë në mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, presim përgjigje!

Ju faleminderit!

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVES  
ESTERI/IDETUM

РЕПУБЛИКА КОСОВО  
ЛИЧНА КАРТА

REPUBLIC OF KOSOVO  
IDENTITY CARD





ID1444000

Име / Имя / Nume / Numara  
**АЈЕТИ**

Ево / Иво / Given name  
**РРАЊИМ**

Датум / Датум / Date of birth  
**10.05.1980**

Спол / Пол / Sex  
**M**

Националност / Националност / Nationality  
**KOSOVAR**

Место / Место / Place of birth  
**STANOC I POSHTEM**

Мандат / Мандат / Mandatum / Mandat / Signature  
*Stanoc Iposhthem*

Датум / Датум / Date of expiry  
**06.12.2031**



221534

